



REPUBLIKA E KOSOVËS


REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA – VLADA – GOVERNMENT



**STRATEGJIA SHETËTËRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR
MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË KUFIRIT**

2020 – 2025



PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
KAPITULLI I	6
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
2. HYRJE	10
3. METODOLOGJIA	11
3.1. MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT (MIK)	12
3.2. VËSHTRIMI POLITIK, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE TOPOGRAFIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	14
4. SFONDI	18
4.1. KORNIZA LIGJORE	20
4.2. ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI	20
4.3. PROCEDURAT	21
4.4. BURIMET NJERËZORE DHE TRAJNIMI	22
4.5. KOMUNIKIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT	22
4.6. INFRASTRUKTURA DHE PAJISJET	23
5. SFIDAT DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË SË MIK-ut	25- 28
5.1. SFIDAT E STRATEGJISË SË MIK-ut	25-26
5.2. OBJEKTIVAT E STRATEGJISË SË MIK-ut	Error! Bookmark not defined.26-28
5.3. BASHPUNIMI DHE BASHKRENDIMI NE TRE SHTYLLAT E MIK-UT	Error! Bookmark not defined.
5.4. BASHKPUNIMI NE FUSHEN E MIGRIMIT DHE AZILIT	40-41
5.5. MEKANIZMI INSTITUCIONAL	41-42
6. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERSIMI	Error! Bookmark not defined.
7. Anekset	43-47

SHKURTESAT

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
ZKKN	Zyra e Koordinatorit Nacional
ANPAJ	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës öAdem Jashariö
ANT	Analiza e Nevojave për Trajnim
APK	Agjencia Pyjore e Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
AKSP	Akademia Kosovare për Siguri Publike
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
ASYCUDA	Sistemi i automatizuar për të dhënat doganore
BE	Bashkimi Evropian
SMK	Sistemi për Menaxhimin Kufitar
C-TPAT	Partneriteti Tregtar Doganor Kundër Terrorizmit
CITES	Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër
CVED	Dokumenti hyrës unik veterinar
DHOK	Dhoma Operative Koordinuese
DHM	Drejtoria për të Huaj dhe Migracion
DMCP	Misionet Diplomatike dhe Konsullatat
DKAM	Departamenti për Kufi, Azil dhe Migracion
DK	Dogana e Kosovës
DP	Drejtori i Përgjithshëm
DOK	Drejtoria e Operatives dhe Kufirit
EUCB	Projekti Doganor i Bashkimit Evropian
EXBS	Kontrollin e Eksportit dhe Sigurinë Kufitare të Ndërlidhur
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
ZBEK/EUOK	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
EWS	Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm
EBCGA	Agjencia e Gardës Kufitare dhe Rojet Bregdetare e BE-së
FAO	Organizata për Bujqësinë dhe Ushqimin
FRONTEX	Agjencia e Gardës Kufitare dhe Rojet Bregdetare e BE-së

FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GIZ	Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GCKD	Grupi për Caktim dhe Koordinim të Detyrave
IPP	Informatat Paraprake për Pasagjerë
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës në Trajnime për Hetimet Penale
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë
ILO	Oficeri Ndërlidhës për Migrim
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
IHR	Rregulloret Ndërkombëtare për Shëndet
ICS	Stacionet e Brendshme për Kontroll
IPPC	Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve
KFOR	Forca e Kosovës
KE	Komisioni Evropian
KiE	Këshilli i Evropës
KSO	Korniza Strategjike Operative
LVUK	Laboratori i Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës
MARRI	Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë
MBNj	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integriteteve Evropiane
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MI	Ministria e Infrastrukturës
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MM	Memorandum Mirëkuptimi
NJPIARK	Njësia e Përbashkët e Inteligjencës për Analizën e Rrezikut dhe

	Kërcënimeve
OIE	Organizata Ndërkombëtare e Epizootive
OAE	Operatori i Autorizuar Ekonomik
PKK	Pikë Kalimi Kufitar
PIK	Pika Inspektuese Kufitare
PK	Policia e Kufitare
PeK	Policia e Kosovës
PSO	Procedura Standarde Operative
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar
SIS	Sistemi Informativ i Shengenit
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë Kosovës
SANCO	Drejtoria e Përgjithshme për Shëndetësi dhe Mbrojtje të Konsumatorit
SELEC	Qendra për Zbatim të Ligjit e Jug-Lindjes
TAIEX	Asistenca Teknike e Njësisë së Shkëmbimit të Informacioneve
TI	Teknologjia Informative
TeR	Termet e Referencës
TRACES	Kontrolli i Tregtisë dhe Sistemi i Eksportit
UA	Udhëzimet Administrative
UNHCR	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
UNCAC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krime
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
WCO	Organizata Botërore e Doganave
WHO	Organizata Botërore e Shëndetësisë
WORLD BANK	Banka Botërore
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZD	Zyra Doganore
ZBD	Zyrat e Brendshme Doganore

KAPITULLI I

- 1. Përmbledhja ekzekutive**
- 2. Hyrje**
- 3. Metodologjia**
- 4. Sfondi**
- 5. Objektivat**

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Republika e Kosovës ka përcaktuar qartë qëllimin dhe vizionin në zbatimin e plotë të konceptit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK), në mënyrë që të forcoj sigurinë dhe menaxhimin e kufirit. Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar të përmbushë të gjitha obligimet që nevojiten në arritjen efektive dhe efikase të këtyre qëllimeve, po ashtu do të ndër marrë reformat e nevojshme në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian (BE) dhe në realizim të anëtarësimit në strukturat Euroatlantike.

Lëvizja e lirë e njerëzve dhe mallrave është element kyç i një sistemi efektiv të MIK-ut që bazohet në parimet e BE-së, në krijimin e një sistemi efikas dhe efektiv të menaxhimit të kufijve që siguron kufij të hapur por të kontrolluar mirë dhe të sigurt, e cila kërkon aplikimin e masave dhe standardeve të kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit. Republika e Kosovës është e palëkundur në respektimin e sistemit efikas të menaxhimit të kufijve të zhvilluar nga BE-ja, të cilat sigurojnë lëvizjen e lirë dhe legjitime të njerëzve dhe mallrave, parandalon krimin ndërkufitar, mbron shëndetin e qytetarëve, gjithmonë duke respektuar standardet më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Qeveria e Republikës së Kosovës, ka dëshmuar rolin e saj si partner i besueshëm për BE-në dhe të tjerët, duke kontribuar për sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe më gjerë. Qeveria e Republikës së Kosovës, në procesin e hartimit të Strategjisë Shtetërore për MIK 2019-2023, merr në konsideratë situatën socio-politike dhe sistemin juridik të Republikës së Kosovës duke krahasuar standardet dhe përvojat e vendeve të tjera në këtë fushë. Kjo strategji e re pesëvjeçare është vazhdim i strategjive të mëparshme të MIK-ut dhe planeve përkatëse të veprimit.

Qëllimi i Strategjisë Shtetërore për MIK është të përmirësojë dhe zhvillojë më tej sistemin aktual të kontrollit kufitar. Në hartimin e kësaj Strategjie për MIK, janë marrë parasysh tre nivelet e bashkëpunimit të autoriteteve kufitare dhe të gjithë komponentët e MIK-ut (kapitulli 3 referohet), me synimin e përgjithshëm të zhvillimit dhe forcimit të kapacitetit ligjor, institucional dhe teknik të Republikës së Kosovës për përafrimin me politikat dhe strategjitë ndërkombëtare të BE-së dhe strategjitë për menaxhimin e kufirit në mënyrë që të krijojë okufij të efikasë, të hapur, por të sigurtë dhe të kontrolluar mirë.

Menaxhimi efikas dhe siguria e kufijve është një ndër prioritetet më të larta të Republikës së Kosovës. Detyra kryesore është të sigurojë ekuilibrin e duhur midis kufijve të hapur, ndërsa në të njëjtën kohë kufijtë e sigurtë dhe të kontrolluar.

Kufijtë të hapur për lëvizjen legjitime të personave dhe mallrave dhe gjithashtu për zhvillimin e tregtisë, ndërsa në të njëjtën kohë kufijtë duhet të jenë të sigurtë dhe të kontrolluar në aspektin e kërcënimeve që vijnë nga migracioni ilegal, trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabanda e mallrave, krimi i organizuar ndërkufitar dhe terrorizmi.

Një sistem i themeluar i MIK-ut kërkon që të gjitha autoritetet përkatëse kufitare me kompetenca në këtë sistem, të punojnë së bashku në një mënyrë efektive dhe efikase. Një sistem i themeluar i MIK-ut, lejon qytetarët të jetojnë në një mjedis të sigurisë dhe lirisë dhe të udhëtojnë lirisht, ku lehtësohet edhe tregtia ndërkufitare, të gjitha këto janë parakushtet kryesore për rritjen ekonomike dhe zvogëlimin e varfërisë. Përmirësimi i flukseve ndërkufitare gjithashtu do të mbështesë zhvillimin e shoqërive më të hapura me mirëkuptim dhe tolerancë më të mirë të fqinjëve të tyre dhe dallimet e tyre kulturore, fetare dhe gjuhësore.

Roli i autoriteteve kufitare¹ është ai i kontrollit dhe sigurimit të kufijve të Republikës së Kosovës, përgjegjëse për parandalimin e migracionit të paligjshëm, trafikimin e qenieve njerëzore (TQNj), kontrabandën e mallrave të të ardhurave, drogës, armëve dhe mallrave të tjera të paligjshme dhe / ose të ndaluara, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisit dhe trashëgimisë kulturore, grumbullimin e detyrimeve doganore dhe taksave, luftën kundër krimit të organizuar dhe ndërkufitar, dhe mbrojtjen e vendit kundër terrorizmit ndërkombëtar. Administrimi i kufijve është një detyrë e ndërlikuar dhe shumëfishe, e cila shpesh kërkon që autoritetet kufitare të ndërmarrin objektiva të shumta dhe nganjëherë të kundërta. Diversiteti dhe kompleksiteti i detyrave të kryera në kufi dhe numri i autoriteteve të përfshira kërkon domosdoshmërinë e vazhdueshme për bashkëpunim të ngushtë brenda autoriteteve, ndërmjet autoriteteve dhe ndërkombëtar.

Kjo strategji e MIK-ut përcakton politikën e Republikës së Kosovës në fushën e krijimit të një sistemi efektiv MIK, krijon një kornizë për identifikimin e qëllimeve strategjike, përcaktimin e objektivave, zbatimin e planeve të veprimit, përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive të autoriteteve kufitare, dhe vendos mbi drejtimet themelore për veprimet gjatë procesit të krijimit dhe realizimit të qëndrueshmërisë afatgjatë dhe stabilitetit të sistemit MIK.

¹ Policia e Kufitare e Kosovës (PKK), Dogana e Kosovës (DK) dhe Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ó i referohesh **ankesit 1**

Qëllimi i kësaj strategjie është të forcoj themelet e MIK-ut, të cilat fundja do të futen në Plan të Veprimit për MIK për zhvillimin e ardhshëm të menaxhimit të kufirit të Republikës së Kosovës, në përputhje me politikat, strategjitë dhe praktikat më të mira të BE-së dhe ndërkombëtare të MIK-ut. Strategjia identifikon sfidat dhe kërcënimet e reja në aspektin e sigurisë së kufijve dhe përcakton objektivat strategjike për 5 vitet e ardhshme (kapitulli 5 i referohet), të gjitha këto që do të përfshihen në Planin e Veprimit të MIK-it me anë të objektivave konkretë². Të dyja, Strategjia dhe Plani i Veprimit, janë "dokumente të gjalla" dhe do të përditësohen në baza të rregullta.

Për zbatimin e Strategjisë Shtetërore për MIK dhe Planin e Veprimit, një nga elementet thelbësore është sigurimi i fondeve të mjaftueshme dhe investim të qëndrueshëm. Qëllimi është të sigurohet se ekziston mbështetje e duhur financiare dhe burime njerëzore për të mundur një menaxhim efektiv dhe efikas të kufirit në Republikën e Kosovës, duke përfshirë përmbushjen e detyrimeve të BE-së në lidhje me sigurinë kufitare. Prandaj, buxheti është një nga faktorët kryesorë që do të garantojë zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për MIK. Aktualisht të gjitha autoritetet kryesore të përfshira në MIK financohen veçmas nga Qeveria dhe ministritë e tyre përkatëse. Sidoqoftë, zbatimi i MIK kërkon bashkëpunim të të gjitha autoriteteve në mënyrë që të përmbushë objektivat strategjike dhe kjo përfshin financimin e zbatimit të Planit të Veprimit të MIK-ut. Gjatë propozimit të buxhetit për çdo vit, autoritetet e përfshira në MIK, mbajnë parasysh se sigurimi i fondeve të mjaftueshme është përfshirë në planifikimet e tyre përkatëse të buxhetit, me qëllim që të sigurohet zbatimi i kërkesave të parapara në Planin e Veprimit për MIK për vitin e ardhshëm. Një analizë vjetore e përbashkët (ndër-autoritete) e kostos do të jetë e pacaktuar për të përmirësuar transparencën e shpenzimeve dhe për të siguruar një vlerësim real të kostos për investimet e ardhshme në MIK. Për më tepër në marrjen e financimit të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për MIK, Qeveria e Republikës së Kosovës do të përpiqet gjithashtu të sigurojë asistencën teknike dhe financimin e BE / ndërkombëtare për të mbështetur këtë proces.

Qeveria e Republikës së Kosovës është plotësisht e vetëdijshme se dhënia e informacionit për qytetarët është një aspekt me rëndësi në rritje. Vetëdijesimi i qytetarëve se menaxhimi efektiv dhe efikas i kufijve është thelbësor për sigurinë e tyre për rreziqet dhe kërcënimet që mund të vijnë nga krimi ndërkufitar. Gjithashtu, qytetarët në PKK duhet të informohen mbi të gjitha risitë që paraqiten në fusha të ndryshme dhe që janë të rëndësishme për njohuritë e tyre. Ky

²Plani i Veprimit i MIK-së do të përmbajë Objektiva konkretë - secila do të ndahet në veprime dhe çdo veprim i ndarë më tej në Aktivitete për të lehtësuar zbatimin e Planit të Veprimit;

informim duhet të bëhet nëpërmes mjeteve elektronike (interneti) mediat dhe materialet tjera informuese/ vetëdijesuese.

Informacioni lehtësisht i kuptueshëm, i qasshëm dhe i azhurnuar mbi çështjet që kanë të bëjnë me kalimin e kufijve shtetëror, ofrohet për publikun përmes QKMK-së nëpërmjet faqes së internetit³ të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Përveç kësaj, në PKK janë të disponueshme broshura informative publike, fletushka dhe postera nga të gjitha autoritetet e përfshira në MIK. Komunikimi me publikun e gjerë inkurajohet në mënyrë aktive me ofrimin e numrave falas të telefonit (thirrje falas) dhe mjeteve të tjera të thjeshta të kontaktit nëpërmjet **internetit**. Të gjitha thirrjet trajtohen si konfidenciale dhe informacioni i marrë kanalizohet në njësitë e duhura të autoritetit kufitar.

2. HYRJE

Implementimi i MIK-ut është prioritetet për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe ndër kriteret kryesore në procesin e integritimit në BE. Strategjia Shtetërore për MIK përfshin zotimet dhe prioritetet e programit të Qeverisë 2020-2023 dhe është në harmoni me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Programin për Reforma në Ekonomi.

Në hartimin e Strategjisë Shtetërore për MIK Strategjinë e MIK, të gjitha dokumentet relevante strategjike, në përputhje me Udhëzimet e Komisionit Evropian për MIK në Ballkanin Perëndimor, Udhëzimet për Menaxhimin e Integruar të Kufirit në Bashkëpunimin e Jashtëm të KE, kriteret themelore të Kopenhagës Dokumenti, Katalogu Shengen, Skema Doganore e BE-së (Blueprints) dhe praktikrat e tjera janë marrë në konsideratë. Në përputhje me prioritetet e identifikuarra dhe përdorimin e praktikave më të mira të aplikuara nga BE, Qeveria e Republikës së Kosovës do të angazhohet për tejkalimin e barrierave ekzistuese dhe sfidave të reja të sigurisë duke zbatuar një sistem efikas dhe efikas të MIK-ut, duke marrë parasysh specifikat e kufijtë e Republikës së Kosovës.

Strategjia shtetërore e MIK-ut (2020-2025) është fleksibile në fushat e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve, veçanërisht në drejtim të zbatimit të objektivave dhe proceseve të punës të përcaktuara në Strategjinë e re dhe Planin e Veprimit të ndërlidhur. Në përputhje me këtë, Strategjia dhe Plani i Veprimit mund të jenë subjekt i rishikimit, në varësi të situatës në terren, interesave strategjike dhe çdo ndryshimi në lidhje me standardet BE / ndërkombëtare,

³ Informacioni përfshin aktivitetet e kryera në kufi, p.sh. Fluksin e udhëtarëve të PKK-së, blloqet rrugore, orarin e punës në PKK, udhëzimet për viza, kërkesat e sigurimit të automjeteve, lëvizjen e kafshëve, përcjelljen dhe informacione të tjera lidhur me to, rregulloret, procedurat, pagesat doganore dhe shpjegimet lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha autoriteteve kufitare.

duke përfshirë zhvillimet e mundshme në drejtim të sfidave të reja dhe të kërcënimeve të reja ndaj sigurisë kufitare.

3. METODOLOGJIA

Strategjia Shtetërore për MIK (2020-2025) dhe Plani i Veprimit 2020-2023 është hartuar nga grupi punues i themeluar nga ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme me vendim nr. 311/2018 të datës 12 korrik 2018. Grupi punues është udhëhequr nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), me pjesëmarrjen dhe kontributin e të gjitha institucioneve relevante të përfshirë në MIK duke përfshirë shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Për të siguruar një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në hartimin e strategjisë, është siguruar një proces konsultimi me publikun dhe palët e interesit, përmes platformës elektronike Qeveritare të konsultimeve me publikun. Grupi punues filloi punën për draftimin e Strategjisë në Shtator të vitit 2018 dhe përfundoi në **Qershor 2019**. Hartimi i strategjisë përfshiu disa faza, duke filluar nga vlerësimi i zbatimit të Strategjinë Shtetërore për MIK dhe Planit të Veprimit 2013-2018, identifikimin e akterëve kryesor, mbledhjen e të të dhënave, shqyrtimin dhe analizimin sfidave kryesore në MIK, si dhe përgatitjen e draft strategjisë së re dhe planit të saj të veprimit. Kjo strategji është hartuar duke u bazuar në parimet kryesore dhe dokumenteve ligjore të bashkangjitura në aneksin 1.

Gjithashtu, strategjia është përgatitur në pajtim me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018⁴ për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit, si dhe në Udhëzuesin e BE-së për MIK dhe kufijtë e jashtëm. Institucionet e përfshira në hartimin e strategjisë janë: Zyra e Kryeministrit (ZKM)⁵, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)⁶, Ministria e Financave (MF)⁷, Ministria e Integritimit Evropian (MIE)⁸, Policia e Kosovës (PeK)⁹, Dogana e Kosovës (DK)¹⁰, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)¹¹, Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar (QKMK)¹², Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AMDHP)¹³, Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ-të)¹⁴ si dhe partnerët ndërkombëtar si: Programi

⁴<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16336>

⁵<http://kryeministri-ks.net/en/>

⁶<https://mpb.rks-gov.net/>

⁷<https://mf.rks-gov.net/>

⁸<http://mei-ks.net/en/home>

⁹<http://www.kosovopolice.com/en/home>

¹⁰<https://dogana.rks-gov.net/en/>

¹¹<http://www.auv-ks.net/en/home>

¹²<https://mpb.rks-gov.net/QKMK.aspx>

¹³<http://www.amdp-rks.org/?page=2,1>

¹⁴<https://www.rks-gov.net/EN/f317/liria-qytetare/organizatat-jo-qeveritare>

për Kontrollin e Eksportit të SHBA-së dhe Programin e Sigurisë së Kufirit (EXBS)¹⁵, Programi Ndërkombëtar i Asistencës në Trajnime për Hetimet Penale (ICITAP)¹⁶, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX)¹⁷, Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)¹⁸, etj.

4. Përkufizimi i përgjithshëm i konceptit të MIK-ut

"Koordinimi dhe bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha institucioneve dhe autoriteteve përkatëse të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin e tregtisë për të krijuar një menaxhim efektiv, efikas dhe të koordinuar të kufirit, në mënyrë që të arrihet objektivi i kufijve të hapur, por të kontrolluara mirë dhe të sigurt"¹⁹. Kufijtë e efektshëm janë ato që balancojnë me sukses konceptin e kufijve të hapur me kufij të sigurt dhe të kontrolluar mirë. Një "kufi efikas" lejon një rrjedhë më të madhe të mallrave legjitime dhe kështu përmirëson mbledhjen e të ardhurave, ndërkohë që siguron siguri më të madhe nëpërmjet forcimit të ligjit dhe zvogëlimin e kërcënimit nga krimi dhe terrorizmi.

4.1 SHTYLLAT KRYESORE TË MENAGJIMIT TË INTEGRUAR TË KUFIRIT (MIK-ut)

Aspektet kryesore të konceptit të MIK-ut janë bashkëpunimi dhe koordinimi të cilat mbështeten nga tri shtyllat në vijim:

- Bashkëpunimi brenda autoriteteve.
- Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar.

4.2 BASHKËPUNIMI BRENDA AUTORITETIT

Bashkëpunimi brenda autoritetit i referohet procedurave, shkëmbimit të informacionit dhe burimeve brenda një ministrie apo autoriteti. Kjo përfshin: bashkëpunimin vertikal dhe

¹⁵<https://www.state.gov/t/isn/ecc/c27911.htm>

¹⁶<https://www.justice.gov/>

¹⁷<https://www.eulex-kosovo.eu/>

¹⁸<https://www.unhcr.org/>

¹⁹<http://ec.europa.eu/transparency/regexpert/index.cfm?do=groupDetail.groupDetailDoc&id=33402&no=4>

horizontal, duke siguruar një ndarje të qartë të përgjegjësiave, komunikim aktiv dhe shkëmbim të rregullt të informatave.

4.3 BASHKËPUNIMI NDËRMJET AUTORITETEVE

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve i referohet bashkëpunimit dhe koordinimit midis ministrive të ndryshme dhe autoriteteve të përfshira në MIK, si dhe ndërmjet zyrtarëve operativë të autoriteteve të ndryshme aktive në Pikë Kalimet Kufitare (PKK-të) dhe në brendi të territorit.

4.4 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e MIK-ut me vendet fqinje dhe vendet e tjera relevante është një mekanizëm efektiv dhe efikas për të lehtësuar udhëtimin dhe tregtinë e ligjshme ndërkufitare dhe në të njëjtën kohë të luftojë krimin ndërkufitar dhe migrimin e parregullt. Ndërsa niveli qendror fokusohet në koordinimin e aspekteve strategjike, siç është mbrojtja dhe mbikëqyrja e përbashkët të kufijve më në rrezik, bashkëpunimi në PKK-të fokusohet në çështjet operacionale taktike.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i referohet bashkëpunimit të ndarë në tre nivele kryesore:

- Bashkëpunimi i nivelit lokal të agjencive kufitare në të dy anët e kufirit.
- Bashkëpunimi dypalësh ndërmjet vendeve kufitare (fqinje), dhe
- Bashkëpunimi shumëpalësh për tju qasur më mirë fushave të përbashkëta në lidhje me çështjet e menaxhimit të kufijve.

Bashkëpunimi dypalësh i referohet takimeve të zhvilluara ndërmjet vendeve fqinje në nivel rajonal dhe qendror në lidhje me situatën në PKK-të të ndryshme, organizimin e patrullimeve të përbashkëta ose koordinimin e mbikëqyrjes kufitare, PKK-të të përbashkëta, shkëmbimin e informacionit, zyrat e përbashkëta të kontaktit dhe pikat e kontaktit, përgatitjen e procedurave për situata emergjente, koordinim dhe bashkëpunim në çështjet e infrastrukturës.

Bashkëpunimi shumëpalësh tregon bashkëpunimin shumëkombësh të përqendruar në krimin ndërkufitar, migracionin e parregullt, trafikimin e qenieve njerëzore, terrorizmin dhe kontrabandën e mallrave, nëpërmjet bashkëpunimit me akterët ndërkombëtarë, pjesëmarrjen në forume rajonale / ndërkombëtare dhe nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

4.5 KOMPONENTËT E SISTEMIT TË MIK-ut

Sistemi MIK-ut përqendrohet në shtatë komponentët e mëposhtëm:

1. Korniza Ligjore;
2. Organizimi dhe menaxhimi;
3. Procedurat;
4. Burimet njerëzore dhe trajnimet;
5. Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave;
6. Infrastruktura dhe pajisjet;
7. Buxheti.

Më poshtë mund të gjeni shtatë komponentët në formë tabelore:




Tabela 1: Komponentët e MIK-ut

5 VËSHTRIMI POLITIK, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE TOPOGRAFIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

5.1 TERRITORI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Territori i Republikës së Kosovës është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kufiri me Republikën e Shqipërisë, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe me Republikën e Malit të Zi është i shënuar, ndërsa me Republikën e Serbisë pritet të shënohet në të ardhmen.

5.2 TË DHËNAT GJEOGRAFIKE

Republika e Kosovës gjendet në qendër të pjesës perëndimore të Gadishullit Ballkanik dhe kufizohet me: Republikën e Shqipërisë në jug-perëndim, Republikën e Maqedonisë së Veriut në jug, Republikën e Malit të Zi në veri-perëndim, Republikën e Serbisë në veri-lindje. Kufiri i Republikës së Kosovës me vendet fqinje kryesisht kalon nëpër male dhe ka karakter natyror.

Pozicioni gjeografik i saj është:

KOORDINATAT GJEOGRAFIKE		
Rajonet	Gjatësia (Latitude)	Gjatësia (Longitude)
Veri ²⁰	43:16:23.9901	20:48:42.9995
Perëndim ²¹	42:43:45.7964	20:00:52.3818
Jug ²²	41:51:07.2305	20:37:17.5130
Lindje ²³	42:39:04.4173	21:47:23.5206

Tabela 2:

Në këtë tabelë janë paraqitur pozicioni gjeografik i Republikës së Kosovës me referencat e gjatësisë (Longitude dhe Latitude)²⁴.

Sipërfaqja e Republikës së Kosovës është 10,910 km² (4,210 sq mi), me gjatësi të kufirit shtetëror si më poshtë:

GJATËSIA E KUFIRIT SHTETËROR SIPAS

²⁰<https://www.latlong.net/c/?lat=43.267239&long=20.802800>

²¹<https://www.latlong.net/c/?lat=42.555833&long=20.077565>

²²<https://www.latlong.net/c/?lat=41.857560&long=20.620308>

²³<https://www.latlong.net/c/?lat=42.651063&long=21.788578>

²⁴<https://latitudelongitude.org/xk/>

SHTETEVE RRETH KOSOVËS	
Republika e Shqipërisë	113.551 km
Republika e Maqedonisë Veriore	170.772 km
Republika e Malit të Zi	79.165 km
Republika e Serbisë	380.068 km
Gjithsejtë	743.556 km

Tabela 3: Në këtë tabelë janë të paraqitur gjatësitë kufitare të Republikës së Kosovës me shtetet fqinjë²⁵.

5.3 TË DHËNAT TOPOGRAFIKE

Kufijtë e Republikës së Kosovës janë rural, malor, ujqor dhe ajror, relievi nëpër të cilin kalon kufiri shtetëror i Republikës së Kosovës është kryesisht kodrinoro-malor. Llojet e relievit ndryshojnë, nga malor i thyer, kodrinor, fushor dhe ujqor.

5.3.1 Pikë kalimet kufitare, numri, lloji dhe kategorizimi

Përcaktimi dhe kategorizimi i Pikë Kalimeve Kufitare (PKK) të trafikut rrugor, hekurudhor dhe ajror, është bërë me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, vendimi nr. 02/124²⁶, datë 10.04.2013, ku bazuar në këtë vendim, Republika e Kosovës i ka tetë PKK-të të kategorisë A, gjashtë PKK-të të kategorisë B dhe tre PKK-të të kategorisë C (shih tabelën nr.4).

5.3.2 KATEGORIZIMI I PKK-ve

Kriteret për kategorizimin dhe standardizimin e PKK-ve janë zhvilluar duke marrë në konsideratë vlerësimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe në bazë të marrëveshjeve ndërshtetërore. Ky kategorizim është bazuar në situatën aktuale, si dhe në përmbushjen e standardeve të BE-së, siç është:

- Qarkullimi i njerëzve dhe mallrave;

²⁵https://en.wikipedia.org/wiki/Geography_of_Kosovo

²⁶http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_124-te_te_Qeverise_2013.pdf

- Niveli i krimit ndërkufitar;
- Migracioni dhe azili;
- Prezenca e autoriteteve të autorizuara në menaxhimin e integruar dhe kontrollin në kufirin shtetëror;
- Numri i personelit.

Përcaktimi i kategorive të PKK-ve është bërë me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në bazë të rekomandimit të Bordit Ekzekutiv për MIK dhe në pajtim me marrëveshjet bilaterale me shtetet fqinje. Sipas nevojës nga ana e Bordit Ekzekutiv për MIK, mund të propozohet ndryshimi i emërtimeve dhe kategorizimi i këtyre PKK-ve. PKK-tëtë transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror, ku sipas rëndësisë dhe veprimtarisë, kategorizohen në:

Kategoria A: PKK-të e kategorisë A janë të hapura 24 orë dhe shërbejnë për qarkullim të personave, mjeteve dhe mallrave. Në këto PKK, vazhdimisht janë të pranishme PK, DK dhe AUV.

Kategoria B: PKK-të e kategorisë B janë të hapura 24 orë dhe shërbejnë për qarkullim të personave, mjeteve dhe mallrave jo-komerciale. Në këto PKK-të, PK është e pranishme 24 orë, ndërsa DK-ja dhe AUV gjatë intervaleve kohore të përcaktuara me marrëveshje bilaterale me shtetet fqinje.

Kategoria C: PKK-të e kategorisë C janë PKK-të të përkohshme dhe janë të hapura për intervale të caktuara kohore. Këto PKK shërbejnë vetëm për qarkullim të personave dhe hapen në pajtim me marrëveshje bilaterale me shtetet fqinje.

PRANIA E AUTOTITETEVE TË AUTORIZUARA TË MIK-ut NË PKK					KATEGORITË E PKK-ve SIPAS RËNDËSISË DHE VEPRIMTARISË	
PIKA E KALIMIT KUFITAR	PK	DK	AUV	SIPAS SHTETEVE	KATEGORI TË PKK-ve	KATEGORITË E PKK-ve SIPAS TRAFIKUT
ANP "Adem Jashari"	PO	PO	PO	Kosovë		Ajror
Vërmicë	PO	PO	PO	Shqipëri	A	Rrugor
Krushevë-Shishtavec	PO	JO	JO	Shqipëri	C	Rrugor
Orqushë	PO	JO	JO	Shqipëri	C	Rrugor
Gllloboqicë-Borje	PO	JO	JO	Shqipëri	C	Rrugor
Qafë e Prushit	PO	PO	JO	Shqipëri	B	Rrugor
Qafë e Morinës	PO	PO	JO	Shqipëri	B	Rrugor
Kullë	PO	PO	PO	Mali i Zi	A	Rrugor
Bërnjak	PO	PO	PO	Serbi	B	Rrugor
Jarinje	PO	PO	JO	Serbi	A	Rrugor
Merdarë	PO	PO	PO	Serbi	A	Rrugor
Mutivodë	PO	JO	JO	Serbi	B	Rrugor

Dheu i Bardhë	PO	PO	PO	Serbi	A	Rrugor
Muçibabë	PO	PO	JO	Serbi	B	Rrugor
Leshak	JO	JO	JO	Serbi	A	Hekurudhor
Hani i Elezit	PO	PO	PO	Maqedoni Veriore	A	Rrugor
Globoqicë	PO	PO	JO	Maqedoni Veriore	B	Rrugor
Stançiq-Bellanovc	PO	PO	PO	Maqedoni Veriore	A	Rrugor
Hani i Elezit	PO	PO	PO	Maqedoni Veriore	A	Hekurudhor

Tabela 4: Përmban praninë e autoriteteve të MIK-ut në PKK, kategoritë e PKK-ve dhe kategorisë së transport²⁷.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me marrëveshje me shtetet relevante fqinje mund të përcaktoj PKK-të të përkohshme, më qëllim të:

- Ushtrimit të aktiviteteve kulturore, sportive, fetare, shkencore, profesionale dhe turistike;
- Reagimit ndaj fatkeqësive natyrore dhe rastet emergjente;
- Zbatimit të marrëveshjeve ndërkufitare;
- Ushtrimit të aktiviteteve bujqësore, blegtorale apo aktivitete të tjera ekonomike.

Standardizimi i PKK-ve, ka për qëllim që PKK-të e kategorisë adekuate duhet të jenë të pajisura me objekte dhe pajisje përcjellëse për ushtrim të kontrollit kufitar sa më të sigurt dhe ekonomik.

5.3.3 KUFIRI I GJELBËR DHE KALTËR

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Policia e Kosovës/Policia Kufitare mban përgjegjësinë për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, në bashkëpunim të drejtpërdrejt me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare. KFOR në bashkëpunim dhe bashkërendim me PK-në aktualisht vazhdon ta mbikëqyrë vijën e gjelbër dhe kaltër me Republikën e Serbisë.

6 SFONDI

Republika e Kosovës ka zbatuar konceptin e MIK-ut bazuar në Udhërrëfyesin dhe Direktivat e BE-së për MIK që nga viti 2006, dhe gjatë kësaj kohe ka hartuar dhe zbatuar tri Strategji Kombëtare të MIK-ut dhe Planet e Veprimit ndërmjet viteve 2009 dhe 2018.

Gjatë kësaj periudhe autoritetet përgjegjëse të Republikës së Kosovës kanë bërë progres të vazhdueshëm në të gjithë parametrat e MIK si: në fushën e përmirësimit të kornizës ligjore, organizimit dhe menaxhimit të autoriteteve kufitare, rritjes së kapaciteteve administrative dhe profesionale të strukturave, zbatimit të procedurave standarde operacionale, zhvillimin të programeve të trajnimit, përmirësimit e infrastrukturës dhe teknologjisë informative, me

²⁷https://sq.wikipedia.org/wiki/Vendkalimet_kufitare_t%C3%AB_Kosov%C3%ABs

qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, lehtësimin e shkëmbimeve tregtare, dhe drejt forcimit të luftës kundër veprimtarive të paligjshme përgjatë kufirit shtetëror dhe rritjes së sigurisë së kufirit.

Zhvillimet më të rëndësishme kanë qenë në lidhje me legjislacionin e harmonizuar me *l'Acquis Communautaire* të BE-së²⁸, në veçanti miratimin e Ligjit për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror dhe Ligjin për Bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK. Për sa i përket organizimit dhe strukturës është themeluar Bordi Ekzekutiv të MIK-ut, i cili udhëhiqet nga Koordinatori Kombëtar për MIK-ut i emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, krijimi i Grupit për Caktim dhe Koordinim të Detyrave të MIK (GKCD) i përfaqësuar nga të gjithë drejtorët e rajoneve të tre autoriteteve kufitare, është një hap i rëndësishëm përpara në drejtim të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe shkëmbimit të informacionit. Me rëndësi të veçantë ishte themelimi i Qendrës Kombëtare për Menaxhim Kufitar (QKMK) që me dy njësitë e saja vartëse, ku përfshihen Njësia e Përbashkët e Inteligjencës për Analizën e Rrezikut dhe Kërcënimeve (NJPIARK) dhe Dhoma Operativo Koordinuese (DHOK), që shërben si pikë kontakti nacionale për shpërndarjen në *òkohe reale* të informacionit dhe qendër për analizën e përbashkët të rrezikut të shumë autoriteteve, duke krijuar një mekanizëm efektiv të përgjithshëm për mbrojtjen e kufijve dhe luftimin e kërcënimeve trans-nacionale. Përveç kësaj, duke u bazuar në marrëveshjetne fuqi janë ngritur tri Qendra të Bashkëpunimit Policor me vendet fqinje, përkatësisht Republikën e Shqipërisë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Ky bashkëpunim shtrihet më tej në patrullat dhe operacionet e përbashkëta kufitare që po ndërmerren nga autoritetet kufitare të Kosovës në bashkëpunim me homologët e tyre nga secila prej tre vendeve. Për më tepër, në maj të vitit 2016, Policia e Kosovës nënshkroi një 'Marrëveshje pune' me FRONTEX (Agjencia Kufitare dhe Rojet Bregdetare Evropiane), e cila krijoi bashkëpunimin operacional midis Kosovës dhe FRONTEX.

Përveç kësaj, një PKK e përbashkët është ndërtuar midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në Vërmicë / Morinë, ndërsa me Republikën e Maqedonisë së Veriut në Stanqiq / Bellanovcështë në ndërtim e sipër. Një rëndësi e veçantë ishte, si pjesë e dialogut të lehtësuar nga BE-ja në mes të Kosovës dhe Serbisë, nënshkrimi i Protokollit Teknik për MIK në Bruksel më 23 shkurt 2012. Ky protokoll teknik parasheh krijimin e

²⁸https://en.wikipedia.org/wiki/Acquis_communautaire

gjashtë pikave të përbashkëta kalimi mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.²⁹

6.1 KORNIZA LIGJORE

Gjatë periudhës në të cilën Republika e Kosovës ka zbatuar MIK-un, me rëndësi të veçantë ka qenë hyrja në fuqi e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, si dhe me Ligjin nr. 06/L-013 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214, dhe gjithashtu Ligji 04 / L-216 për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, shtojca nr.2.

Gjatë hartimit të ligjeve kryesore të ndërtuara për të siguruar zbatimin efektiv të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të MIK-ut, është marrë në konsideratë legjislacioni përkatës i BE-së dhe udhëzuesit për praktikën më të mira, duke përfshirë por pa u kufizuar, në kodin e kufijve të Shengenit³⁰, rekomandimet nga katalogu i Schengenit mbi kontrollin e kufijve të jashtëm³¹, konkluzionet e KE-së të 4-5 dhjetorit 2006 mbi MIK³², Udhëzuesit për MIK në bashkëpunimin e jashtëm të KE 2010³³, Projekti ëBlueprinti i Doganës së BE-së³⁴; Praktikën më të mira të BE-së, Rregullorja e BE-së për Kufirin dhe Gardën Bregdetare Evropiane (2016/16240), Rregullorja e KE-së për krijimin e një Kodi të Komunitetit për Viza (Kodi i Vizave) (810/2009)³⁵.

Deri më tani, në fushën e MIK-ut, Republika e Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen bilaterale dhe multilaterale me shtetet fqinje dhe shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare (shtojca 2).

6.2 ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI

²⁹ Si pjesë e protokollit teknik MIK të miratuar, gjashtë CCP të përkohshme janë në veprim në pritje të ndërtimit të gjashtë PPK të përhershëm

³⁰ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32016R0399>

³¹ <http://eapmigrationpanel.org/en/news/catalogue-recommendations-and-best-practices-external-borders-return-and-readmission>

³² https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_Data/docs/pressdata/en/jha/100933.pdf

³³ <https://europa.eu/capacity4dev/MIK-eap/document/1-guidelines-integrated-border-management-european-commission-external-cooperation-european>

³⁴ https://ec.europa.eu/taxation_customs/eu-training/customs-blueprints-pathways-better-customs_en

³⁵ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM%3Ajl0028>

Koordinimi, menaxhimi dhe zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për MIK mbikëqyret nga MPB-ja, respektivisht nga Koordinatori Nacional për MIK i mbështetur nga Bordi Ekzekutiv dhe Sekretariati i MIK-ut duke u bazuar në Ligjin për Bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK-ut. Koordinatori Nacional dhe Bordi Ekzekutiv i MIK-ut, siguron zbatimin efektiv të Strategjisë së MIK-ut.

Procesi i MIK-ut mbështetet gjithashtu edhe nga Grupi për Caktim dhe Koordinim të Detyrave (GCKD), i cili u krijua për të siguruar koordinim dhe bashkëpunim efektiv midis tri autoriteteve kufitare në nivel rajonal dhe lokal, duke përfshirë shkëmbimin e strukturuar të informacionit. Përveç kësaj, GCKD është përgjegjës për caktimin e prioriteteve dhe veprimtarive specifike operacionale të autoriteteve kufitare. GCKD mbështetet nga Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar (QKMK) në koordinimin e aktiviteteve operacionale dhe shkëmbimin e informacionit në kohë reale. QKMK-ja u funksionalizua në Janar 2013 e cila është qendër kryesore dhe konsiderohet një aset i rëndësishëm të kapacitetit të Republikës së Kosovës për të menaxhuar në mënyrë efektive sigurinë e kufijve të tyre, luftimin e krimin ndërkufitar dhe krimit të organizuar, si dhe ndihmën në luftën kundër korrupsionit. QKMK është qendra kryesore për koordinimin, komunikimin, mbështetjen dhe shkëmbimin e informacionit për tri autoritetet kufitare (PK, DK dhe AUV). QKMK është e angazhuar nga përfaqësuesit e tri autoriteteve kufitare dhe vepron 24/7. NjPIARK si pjesë integrale e QKMK-së, është përgjegjëse për hartimin e raporteve të përbashkëta analitike si dhe profilizimin e personave dhe subjekteve të ndryshme që paraqesin rrezik dhe kërcënim për sigurinë kufitare. NjPIARK trajton, analizon, referon rastet tek autoritetet kompetente për parandalimin e krimit ndërkufitar dhe krimin e organizuar. Për më tepër, Qendra ka një Dhomë Operativo Koordinuese (DhOK) me qasje të plotë në CCTV-TVQM për të gjitha PKK-të.

6.3 PROCEDURAT

Zbatimi praktik i MIK, është mbështetur nga një numër i Procedurave Standarde të Operimit (PSO), të cilat janë miratuar nga Koordinatori Nacional për MIK. PSO-të përfshijnë ato për GCKD, QKMK dhe NjPIARK, grupi i plotë i PSO-ve që ndërlidhen me MIK-un janë renditur në **Shtojcën nr.2**, detyrat e caktuara të tri autoriteteve kufitare (PK, DK dhe AUV-it), janë përcaktuar nga PSO-të. PSO-të ekzistuese rishikohen rregullisht për të siguruar harmonizimin me ndryshimet në legjislacion, rregulloret dhe gjithashtu për të menaxhuar progresin profesional dhe rritjen e praktikave të punës së autoriteteve kufitare në përputhje me udhëzimet dhe praktikat më të mira të BE-së (duke përfshirë Katalogun e

Shengenit mbi Kontrollin e Kufijve të Jashtëm, Udhëzimet mbi MIK-unë Bashkëpunimin e Jashtëm dhe Blueprint-in e Doganave të BE-së etj.).

6.4 BURIMET NJERËZORE DHE TRAJNIMI

Të gjitha autoritetet kufitare kanë zhvilluar kapacitetet e tyre respektivisht në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (MBNj) bazuar në legjislacionin kombëtar të çdo autoriteti dhe nëpërmjet adaptimit të standardeve ndërkombëtare. Këto sisteme të reja të MBNj-ve përfshijnë përmirësime të rëndësishme në rekrutimin dhe trajnimin e personelit. Për më tepër, ekzistojnë sisteme të veçanta dhe të integruara për rekrutim të personelit, menaxhimin dhe vlerësimin e performancës, duke përfshirë: përshkrimin e vendeve të punës, avancimin në karrierë, trajnimin, transferimin, shkarkimin, kushtet e punës dhe politikat e shëndetit dhe sigurisë, etj. Të gjitha autoritetet kufitare kanë zhvilluar gjithashtu programe trajnimi të bazuara në analizat e nevojave të kryera nga çdo autoritet dhe mbi praktikat më të mira ndërkombëtare. Gjatë periudhës së Strategjisë së fundit për MIK, janë zhvilluar trajnime të shumta ndër - autoriteteve të mbështetura nga partnerët ndërkombëtarë³⁶. Për më tepër, trajnerët nacionalë kanë dhënë trajnime për Kodin e Etikës dhe Kundër Korrupsionit për të gjithë personelin e autoriteteve kufitare në të gjithë vendin, duke përfshirë kryerjen e kurseve të trajnimit në të gjitha PKK-të.

6.5 KOMUNIKIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit realizohet në kohë reale në të gjitha PKK-të, Stacionet Policore për Mbikëqyrjen e Kufirit (SPMK)-të, Terminalet Doganore dhe Zyrat Rajonale të AUV-së. Gjatë periudhës së Strategjisë së fundit të MIK-ut ka pasur zhvillime dhe avancime të rëndësishme në aspektin e Teknologjisë së Informacionit (TI) dhe shërbimeve në të gjitha autoritetet kufitare. Të gjitha PKK-të e Republikës së Kosovës janë të lidhur në internet me Sistemin e Menaxhimit të Kufirit (SMK), një sistem ku PK-ja regjistron të gjitha hyrjet / daljet përmes kufirit shtetëror dhe gjithashtu çdo incident që lind në PKK. SMK është e ndërlidhur me sistemet relevante të Republikës së Kosovës. Sa i përket DK-së, TI-ja është avancuar, duke mundësuar që 100% e të gjitha deklaratave doganore të përpunohen pa letra përmes Sistemit Automatik për të Dhëna Doganore (ASYCUDA Word), i cili ka pasur një ndikim të madh në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për komunitetin e biznesit.

³⁶Programi për Kontrollin e Eksportit të SHBA-së dhe Sigurinë e Kufijve (EXBS), EULEX, Projektet e Binjakëzimit të BE-së dhe X

Përveç këtij sistemi DK-ja ka zhvilluar sistemin për zbatimin e ligjit LES. AUV ka bërë gjithashtu rrugë të rëndësishme në lidhje me TI-në, duke zgjeruar linjën e intranetit dhe duke aplikuar sistemin elektronik (AUV-it) në të gjitha Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) dhe Zyrat Rajonale (ZR). Zhvillimi i QKMK-së bazohet në Plan Zhvillimor 2014-2019 të miratuar nga Qeveria, përmes të cilit është bërë përparim i dukshëm në fushën e TI dhe shkëmbimit të informacionit, veçanërisht në drejtim të koordinimit të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit në kohë reale për të tri autoritetet kufitare. Gjithashtu, është arritur mbulimi nga Qendra me (CCTVó TVQM)³⁷ në të gjitha PKK-të. Së fundmi është zhvilluar platforma e Sistemit të Menaxhimit të Rasteve (CMS)³⁸ dhe Inteligjenca e Biznesit dhe Analiza (BI - QlikView)³⁹, e cila ka ngritur kapacitetet e dy njësive vartëse të QKMK-së në funksionalizmin dhe realizimin e misionit të saj.

Në maj të vitit 2016, Policia e Kosovës nënshkroi një 'Marrëveshje pune' me FRONTEX, duke krijuar bashkëpunim operacional⁴⁰. Qëllimi i marrëveshjes është të përmirësojë menaxhimin e kufirit të Kosovës dhe të mbështesë autoritetet kufitare në luftën kundër migracionit të parregullt dhe kriminalitetit ndërkufitar. Që nga nënshkrimi i marrëveshjes PKK kontribuon me të dhënat në Rrjetin e Analizave të Ballkanit Perëndimor (WBAN) dhe gjithashtu si pjesë e WBAN-it, marrin pjesë në takimet e gjashtë vendeve relevante Rrjetet e Analizës së Riskut.

6.6 INFRASTRUKTURA DHE PAJISJET

Gjatë viteve të fundit Republika e Kosovës ka zhvilluar vazhdimisht infrastrukturën që lidhet me MIK-un: renovimin dhe ndërtimin e PKK-ve moderne dhe SPMK-ve. Në Dhjetor të vitit 2018 me Republikën e Shqipërisë, në Vërmicë - Morinë është hapur PKK-ja e përbashkët e kategorisë A. Përveç kësaj, janë themeluar tri PKK të përbashkëta të kategorisë C në Shishtavec - Krushevë, Gllboqicë - Borjë dhe Orqushë. Me Republikën e Maqedonisë së Veriut ka filluar ndërtimi i PKK-së së re të përbashkët e kategorisë A Stançiq - Belanovc me financim të BE-së dhe i mbështetur nga dy shtetet. Si pjesë e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja në mes të Kosovës dhe Serbisë, Protokollin Teknik i MIK-ut u nënshkrua më 23 shkurt 2012. Ky Protokoll teknik parashih ndërtimin e 6 (gjashtë) PKK-ve të reja të përbashkëta ndërmjet dy vendeve. Midis dhjetorit 2012 dhe shkurtit 2013, u hapën gjashtë PKK: Jarinjë / Rudnicë, Bërnjak / Tabalije, Merdarë / Merdare, Dheu i Bardhë / Koncul, Mutivodë / Mutivode dhe Muçibabë / Depce, duke lejuar lëvizjen e qytetarëve, automjeteve dhe mallrave ndërmjet

³⁷ https://en.wikipedia.org/wiki/Closed-circuit_television

³⁸ <https://www.prevail.net/2018/12/17/what-is-a-case-management-system/>

³⁹ <https://en.wikipedia.org/wiki/Qlik>

⁴⁰ Karakteristikat kryesore të marrëveshjes janë: zhvillimi i trajnimeve; ndarjen e informacionit dhe gjithashtu produktet analitike, duke përfshirë vlerësimet e kërcënimeve, analizat e rrezikut dhe raportet e situatës.

Kosovës dhe Serbisë. Ndërtimi i dy PKK-ve të reja të përhershme në Merdarë dhe Mutivodë është në vazhdim dhe pritet që PKK-të të përfundojnë dhe të jenë plotësisht funksionale në vitin 2019. Përveç kësaj, dy PKK-të e përkohshme të reja janë ndërtuar në Kapi dhe Izvor dhe pritet funksionalizimi i tyre. Për më tepër, dymbëdhjetë Stacione Policore për Mbikëqyrje Kufitare (SPMK) janë ndërtuar ose meremetuar tërësisht në tri rajone të Policisë Kufitare (Veri, Lindje dhe Perëndim). Autoritetet e MIK-ut kanë avancuar vazhdimisht cilësinë dhe spektrin e pajisjeve të vëna në dispozicion për stafin e tyre përkatës, me qëllim që zyrtarët të kryejnë detyrat e caktuara për mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror në mënyrë efektive dhe efikase. Përveç pajisjeve të blera nga autoritetet me buxhetin vetanak, gjithashtu jemi pajisur me donacione të ndryshme nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare.⁴¹

7. SFIDAT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE PËR MIK-un NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

7.1 SFIDAT PËR MIK-ut NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Autoritetet Kufitare të Republikës së Kosovës kanë pasur përparime mbresëlënëse dhe të rëndësishme në zbatimin e konceptit të MIK-ut. Sidoqoftë, përkundër përparimit pozitiv të bërë deri tani, Qeveria e Republikës së Kosovës pranon se ka ende më shumë për t'u arritur në një numër fushash të menaxhimit kufitar dhe gjithmonë ka hapësirë për zhvillim dhe përmirësim të mëtejshëm.

Përderisa shumë pjesë të konceptit të MIK-ut, në aspektin e bashkëpunimit brenda autoritetit, ndërmjet autoriteteve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, janë miratuar plotësisht, Autoritetet Kufitare të Republikës së Kosovës pranojnë se implementimi i plotë i të gjitha metodologjive të MIK-ut ende duhet të realizohet. Rrjedhimisht, Strategjia dhe Plani i Veprimit për MIK siguron vëmendje për të garantuar zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet agjencive dhe bashkëpunimit ndërkombëtar (duke përfshirë modelin e kontrollit të qasjes me katër nivele⁴²) dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, operationale dhe teknike, së bashku me trajnimin e duhur.

⁴¹ Donacioni i pajisjeve ka përfshirë shumë palë të interesuara ndërkombëtare, duke përfshirë: EXBS, EULEX, Projektet e Binjakëzimit të BE dhe zyra e BE-se në Kosovë.

⁴² Përshkruar si thelbi i MIK në Listën Shengen të BE-së mbi Kontrollin e Kufijve të Jashtëm dhe Kthimin dhe Ripranimin (Lista e Përditësuar e Shengenit e BE mbi Kontrollin, Kthimin dhe Ripranimin e Kufijve të Jashtëm - Rekomandimet dhe praktikatat më të mira, Këshilli i BE-së, 7864/09);

Pavarësisht nga progresi i arritur deri më tani, menaxhimi i sigurisë së kufijve është një proces kompleks dhe shumëdimensional i cili shpesh kërkon që autoritetet kufitare të përcaktojnë objektiva të shumta dhe nganjëherë kontradiktore. Rrjedhimisht objektivat e kësaj Strategjie dhe Plani të Veprimit për MIK janë, në përputhje me Udhëzimet e BE-së, për të përmirësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit midis autoriteteve vendore dhe mekanizmave tjera ndërkombëtarë, me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe operacionale të autoriteteve kufitare për kryerjen më të mirë të kontrollit kufitar. Rritja e kapaciteteve të autoriteteve kufitare për të luftuar në mënyra më efikase krimin ndërkufitar dhe veçanërisht për të zbuluar migracionin e parregullt, trafikimin e qenieve njerëzore (TQNj) dhe të gjitha format e kontrabandës, është me rëndësi të jashtëzakonshme në luftimin e kërcënimeve të sigurisë së Republikës së Kosovës.

Rajoni i Ballkanit historikisht njihet si rrugë tranzitore për të gjitha format e aktiviteteve kriminale. Disa nga sfidat më serioze dhe kërcënimet e reja me të cilat ballafaqohet Republika e Kosovës në lidhje me sigurinë dhe menaxhimin e kufijve, të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me rolin e autoriteteve kufitare dhe zbatimin e Strategjisë Shtetërore dhe Planit të Veprimit për MIK, janë ato që paraqiten nga emigracioni i parregullt, kontrabanda e narkotikëve, krimi transnacional dhe i organizuar, terrorizmi, financimi i terrorizmit dhe lëvizjes së luftëtarëve të huaj në rajon. Rrjedhimisht, në mënyrë që autoritetet kufitare dhe institucionet e tjera të zbatimit të ligjit të trajtojnë në mënyrë efektive këto sfida dhe kërcënimet e reja për sigurinë kombëtare, publike dhe kufitare të Kosovës, ekziston nevoja për të forcuar vazhdimisht kapacitetin e përgjithshëm të MIK ut.

Një tjetër sfidë për autoritetet kufitare të Kosovës është kontrolli i kufirit me Serbinë për shkak të mosmarrëveshjeve politike dhe territoriale në vazhdim, ekziston një mungesë e kontrolleve efektive dhe të strukturuar të kufirit. Rrjedhimisht kufiri me Serbinë është shumë poroz, duke ofruar mundësi të mjaftueshme për veprimtari kriminale të paligjshme ndërkufitare dhe duke lejuar rrjetet e krimit të organizuar trans-nacional të funksionojnë dhe të përparojnë.

7.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE PËR MIK-un NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Objektivi strategjik i MIK-ut është bashkërendimi dhe bashkëpunimi i plotë kombëtar dhe ndërkombëtar midis të gjitha autoriteteve relevante kufitare të përfshira në kontrollin dhe sigurinë kufitare, me qëllim krijimin e një sistemi efikas dhe efektiv të menaxhimit të kufirit, i cili do të garantojë kufijtë e hapur por të kontrolluar dhe të sigurt.

Objektivat strategjike të parashikuara në këtë strategji të re 5-vjeçare të MIK-ut janë të përqendruara në bashkëpunimin brenda autoriteteve, bashkëpunimin midis autoriteteve, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe bashkëpunimin në fushën e migracionit. Strategjia dhe Plani i Veprimit për MIK është një dokument i gjallë që mund të plotësohet vazhdimisht dhe të ndryshohet në aspektin e zbatimit, duke iu përshtatur legjislacionit të ri dhe dokumenteve të reja strategjike në përputhje me gjendjen, interesat strategjike të Republikës së Kosovës dhe ndryshimet brenda standardeve të BE-së. Qëllimi i kësaj strategjie është të avancojë një sistem të sigurt kufitar që do të integrojë të gjitha autoritetet për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror përmes aplikimit të duhur të MIK të paraparë me Udhëzimet e BE-së për MIK dhe Katalogun e Schengen të BE-së.

Objektivat strategjike janë:

- **Përditësimi dhe harmonizimi i legjislacionit të Autoriteteve të MIK ut** - ky objektivi përfshinë përditësimin e legjislacionit primar dhe sekondar me zhvillimet e legjislacionit të vendit dhe harmonizimi i tij me Direktivat dhe praktikën e reja të BE-së.
- **Përmirësimi i bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet autoriteteve** - Me theks të veçantë në shkëmbimin / shpërndarjen e informatave dhe analizën e përbashkët të rrezikut, duke përfshirë zhvillimin e mëtejshëm të Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (QKMK)⁴³ në lidhje me shfrytëzimin e plotë të Grupit për Caktim dhe Koordinim të Detyrave.
- **Forcimi i kapaciteteve të autoriteteve kufitare** - Për të luftuar më efektivisht sfidat më serioze të sigurisë kufitare dhe kërcënimet në zhvillim, në veçanti zbulimin e migracionit ilegal / të parregullt, trafikimit me qenie njerëzore (THB) dhe të gjitha format e kontrabandimit ilegal (përfshirë narkotikët, armët, mallrat me shfrytëzim të dyfishtë etj.) dhe duke goditur krimin trans-kufitar, ndërkufitar dhe të organizuar duhet të avancohet mënyra e përzgjedhjes së zyrtarëve dhe trajnimit të tyre në fushat e avancuara dhe specializuara. Zhvillimi, përmirësimi dhe investimi i vazhdueshëm në infrastrukturën dhe pajisjet kufitare (duke përfshirë përdorimin dhe mirëmbajtjen e përbashkët), duke siguruar infrastrukturën dhe pajisjet të mjaftueshme për të mbështetur Autoritetet Kufitare për të qenë në gjendje të kryejnë detyrat e tyre të caktuara në mënyrë efektive.
- **Zbatimi i plotë i Dialogut të lehtësuar / mundësuar nga BE-ja mbi Protokollin Teknik të MIK-ut** – Ky objektivi përfshinë ndërtimin e të gjitha pikave permanente të

⁴³Zbatimi i plotë i Planit Zhvillimor të QKMK-së duke përfshirë edhe Pikën Kombëtare të Kontaktit për shkëmbimin e informacionit "në kohë reale" midis të gjitha autoriteteve kufitare të përfshira e kontaktit në dhe nga pikë kalimtare dhe kufirin e gjelbër dhe të kaltër;

kalimit kufitar me Serbinë, të financuara nga BE-ja dhe në procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të gjitha Autoritetet Kufitare do të kryejnë në mënyrë efektive spektrin e plotë të detyrave përkatëse të kontrollit kufitar (kontroll, vëzhgim dhe mbikëqyrje) përgjatë kufirit të gjelbër me Serbinë.

- **Avancim i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe anëtarësimi i plotë në organizata ndërkombëtare** - Duke përfshirë zhvillimin e Modelit Katër Qasje të kontrollit sipas Katalogut Schengen, që përfshin masat e marra në vendet e treta, të tilla si politika e përbashkët për viza, bashkëpunimi me vendet e treta fqinje, masat e kontrollit kufitar në kufijtë e jashtëm, duke përfshirë analizën e përbashkët të rrezikut.

9. BASHKËPUNIMI DHE BASHKËRENDIMI NË TRI SHTYLLAT E MIK-ut

Ky kapitull i Strategjisë MIK përcakton bashkëpunimin brenda autoritetit, ndërmjet autoriteteve dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar në lidhje me komponentët primarë të MIK-ut (Korniza Ligjore, Organizimi dhe Menaxhimi, Procedurat, Burimet Njerëzore dhe Trajnimet, Komunikimi dhe Shkëmbimi i Informacionit, dhe Infrastruktura dhe Pajisjet), dhe gjithashtu i bashkon këto me aktivitetet e ardhshme në trajtimin e sfidave kryesore me të cilat ballafaqohen autoritetet kufitare dhe në zbatimin e objektivave strategjike për MIK në Republikën e Kosovës.

9.1. BASHKËPUNIMI BRENDË AUTORITETEVE (POLICIA KUFITARE, DOGANA E KOSOVËS DHE AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË)

Sa i përket bashkëpunimit brenda autoritetit, shumica e komponentëve të konceptit të MIK-ut janë miratuar plotësisht, megjithatë Autoritetet Kufitare të Kosovës pranojnë se gjithnjë ka hapësirë për avancim të mëtejshëm dhe përpiqen të sigurojnë përparim të vazhdueshëm pozitiv teknik dhe procedural në përputhje me zhvillimet e IBM-it të BE-së.

Sa i përket **kornizës ligjore**, të gjitha autoritetet kufitare përditësojnë ligjet dhe aktet nënligjore të zbatueshme në MIK dhe Sigurinë Kufitare në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe Acquis Communautaire⁴⁴ të BE-së. Duke iu referuar **organizimit dhe menaxhimit** strukturat aktuale vlerësohen si të kënaqshme dhe janë të harmonizuara me aktet ligjore në fuqi, duke siguruar që çdo autoritet kufitar të kryejë në mënyrë efikase dhe efektive detyrat e tyre përkatëse, veçanërisht në kryerjen e kontroleve të lidhura me kufij dhe detyrave të kontrollit. Të gjitha procedurat e ndërmarra nga secili autoritet kufitar janë në përputhje me standardet e BE dhe janë të përcaktuara me ligje, akte nënligjore dhe PSO.

Në fushën e menaxhimit të **burimeve njerëzore**, autoritetet kanë ndërmarrë veprime të nevojshme për përmbushjen e njësisive me personel adekuat dhe profesional sipas strukturave organizative.

⁴⁴ https://en.wikipedia.org/wiki/Acquis_communautaire

Shumëllojshmëria dhe kompleksiteti i detyrave të kryera në kufi kërkon personel të organizuar mirë dhe të trajnuar në mënyrë adekuate për tu marrë të gjitha sfidat për të zbatuar një sistem efektiv MIK-ut. Qëllimi i çdo autoriteti kufitar është që të sigurojë personel të trajnuar në mënyrë adekuate për të ndërmarrë detyrën e shumëfishtë të menaxhimit të kufijve. Kurrikulat e **trajnitimit** të miratuara nga autoritetet kufitare do të vazhdojnë të përfshijnë modelet e FRONTEX⁴⁵, CEPOL⁴⁶, TAIEX⁴⁷, DG-TAXUD⁴⁸, WCO⁴⁹, MARRI⁵⁰, Doracakun e Schengenit⁵¹ etj. si dhe trajnime të specializuara të ofruara nga EXBS⁵², ICITAP⁵³, EULEX⁵⁴, UNHCR⁵⁵ dhe IOM⁵⁶, etj. Përveç kësaj, të gjitha autoritetet kufitare kanë identifikuar nevoja të mëtejshme për trajnim, veçanërisht në fusha të specializuara që kanë të bëjnë me MIK, duke përfshirë mbikëqyrjen e kufirit, hetimin penal dhe përdorimin operativ të pajisjeve teknike, veçanërisht në lidhje me kontrollet e vijës së dytë. Çdo Autoritet Kufitar është përgjegjës për trajnimin e personelit të vet dhe të gjithë janë plotësisht të angazhuar që të sigurojnë që niveli më i lartë të trajnimeve profesionale për t'u marrë me menaxhimin e kufijve dhe detyrat e sigurisë tu ofrohet stafit e tyre, duke përfshirë trajnime të specializuara për zhvillim të mëtutjeshëm të tyre. Trajnimi brenda autoritetit organizohet në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, duke përfshirë edhe 'trajnimin e trajnerëve'.

Secili autoritet kufitar ka investuar në mënyrë të konsiderueshme në fushat e **komunikimit** përbrenda shërbimit dhe **shkëmbimit të informacionit**, në veçanti zhvillimin e sistemeve përkatëse të TI-së. Çdo autoritet kufitar vepron me sistemin e vet të menaxhimit të informacionit, gjegjësisht: 1) Policia Kufitare e Kosovës: Sistemi i Menaxhimit të Kufirit (SMK⁵⁷), i cili është i lidhur me Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK); 2) Doganat e Kosovës: Sistemi i Automatizuar për të Dhënat Doganore (ASYCUDA) World⁵⁸ (përveç kësaj DK ka prezantuar së fundmi një Sistem të ri të Menaxhimit Zbatimit të Rasteve); dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës operon sistemin e tyre të brendshëm AUV. Të gjitha sistemet e menaxhimit të informacionit të autoriteteve kufitare kanë lidhje në Qendrën Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (QKMK⁵⁹), të cilat janë të qasshme drejtpërdrejt nga stafi i duhur i verifikuar në Qendër. Sa i përket **infrastrukturës dhe pajisjeve**, çdo autoritet kufitar është aktualisht përgjegjës për veten e tyre, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen, megjithatë me shtimin e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar krijohet një shkallë më e lartë e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës dhe pajisjeve.

⁴⁵ Agjencia Evropiane e Rojeve Bregdetare (FRONTEx)

⁴⁶ Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnime për Zbatimin e Ligjit (CEPOL)

⁴⁷ Njësia për Asistencë Teknike në Shkëmbim të Informacionit (TAIEX)

⁴⁸ Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Bashkimit Doganor (DG-TAXUD);

⁴⁹ Organizata Botërore e Doganave (WCO)

⁵⁰ Iniciativa Rajonale për Migracion Azil dhe Refugjatë (MARRI)

⁵¹ Doracaku praktik i BE-së për rojet kufitare (Doracaku Shengen);

⁵² Programi për Kontrollin e Eksportit dhe Sigurinë e Kufijve (EXBS)

⁵³ Programi i Asistencës për Trajnimin Hetimor Penal Ndërkombëtar (ICITAP);

⁵⁴ Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX);

⁵⁵ Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjat (UNHCR);

⁵⁶ Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM);

⁵⁷ http://www.europarl.europa.eu/doceo/document/E-8-2014-011206_EN.html

⁵⁸ <https://asycuda.org/en/>

⁵⁹ Referohet Komunikimi dhe Shkëmbimi i Informacionit Ndër-Agjenci

9.2. BASHKËPUNIMI NDËRMJET AUTORITETEVE

Qëllimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve, Policisë Kufitare, Doganës, Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe autoriteteve tjera të përfshira në MIK është që të përmirësojë aftësinë e çdo autoriteti për të kryer detyrat e caktuara përkatëse në mënyrë të përshtatshme, efikase dhe me kosto efikase për të punuar ngushtë së bashku kudo që është e mundur.

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve është thelbësor, pasi kjo rrit efikasitetin e verifikimeve dhe kontroleve kufitare. Për më tepër, bashkëpunimi ndërmjet agjencive përmirëson parandalimin e krimit ndërkufitar, dhe mundëson bashkëpunimin në lidhje me shkëmbimin e informacionit, analizën e përbashkët të rrezikut dhe zbulimin / hetimin e krimit, si dhe përdorimin e gjerë të bazave të dhënave.

Janë bërë përmirësime të konsiderueshme në përputhje me kërkesat e BE-së në lidhje me **legjislacionin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve**, duke mundësuar rritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet autoriteteve kufitare.

I gjithë legjislacioni i lidhur me MIK-un është plotësisht i harmonizuar me direktivat e BE-së dhe azhurnohet sipas nevojës me ndonjë ndryshim përkatës në legjislacionin kombëtar ose të BE-së. Për më tepër, gjatë periudhës së kësaj strategjie gjithashtu do të ndërmerret një rishikim i legjislacionit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit në përputhje me standardet dhe BE / Ndërkombëtare. Përveç tri autoriteteve kufitare parësore, 'Marrëveshjet' janë lidhur me të gjitha institucionet e tjera qeveritare me role dhe përgjegjësi lidhur me sigurinë e kufirit, por nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në MIK.

Në lidhje me **Kornizën Institucionale përbrenda Agjencive të MIK-ut**, koordinimi, menaxhimi dhe zbatimi i Strategjisë / Planit të Veprimit të MIK-it mbikëqyret nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), nëpërmjet Koordinatorit Kombëtar të MIK-ut⁶⁰, të mbështetur nga Bordi Ekzekutiv i MIK-it dhe Sekretariati i MIK-ut.

Përveç kësaj, Koordinatori Kombëtar i MIK-ut dhe Bordi Ekzekutiv i MIK-ut janë përgjegjës për rritjen e koordinimit dhe bashkëpunimit midis autoriteteve kufitare, duke përfshirë zhvillimin e analizës së përbashkët të rrezikut dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta, të gjitha të cilat mbështesin kapacitetin e autoriteteve kufitare për të trajtuar të gjitha format e krimeve ndër-kufitare. Takimet e Bordit Ekzekutiv të MIK, të kryesuar nga Koordinatori Kombëtar i MIK, mbahen çdo tre muaj dhe përfaqësohen nga Drejtorët e Autoriteteve Kufitare dhe personeli tjetër i lartë.

Mekanizmi i MIK-ut gjithashtu mbështetet nga Grupi për Koordinim dhe Caktim të Detyrave (GKCD), i cili është krijuar për të siguruar koordinim efektiv dhe bashkëpunim midis tre autoriteteve kufitare në nivel rajonal dhe lokal, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit të strukturuar. Përveç kësaj, GKCD është gjithashtu përgjegjëse për përcaktimin e prioriteteve dhe aktiviteteve specifike operacionale të autoriteteve kufitare. GKCD takohet çdo muaj dhe niveli i përfaqësimit është ai i drejtorëve rajonal nga të tre autoritetet, si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera relevante kombëtare.

⁶⁰ Emërimi i Koordinatorit Kombëtar të MIK-it bëhet nga Ministri i Punëve të Brendshme dhe miratohet nga Qeveria.

MIK-u, gjithashtu mbështetet nga Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (QKMK) në koordinimin e aktiviteteve operacionale dhe shkëmbimin e informacionit. QKMK u hap në janar 2013 dhe konsiderohet si një nga asetet më të rëndësishme të Republikës së Kosovës për të menaxhuar në mënyrë efikase dhe efektive sigurinë e saj kufitare, për të luftuar krimin ndërkufitar dhe të organizuar dhe për të ndihmuar në luftën kundër korrupsionit.

Përveç kësaj, QKMK ka kapacitetin për të mbështetur dhe koordinuar planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të kontrollit kombëtar të kufijve dhe gjithashtu ka aftësinë për të koordinuar masat operacionale me vendet e tjera anëtare të BE dhe vendet e treta. QKMK ka një Njësi të Përbashkët të Inteligjencës për Analizën e Rrezikut dhe Kërcënimeve (NJPIARK), e cila është përgjegjëse për ndërmarrjen e analizës së përbashkët të rrezikut dhe zhvillimin e profileve të rrezikut / synimeve dhe vlerësimet e kërcënimeve të sigurisë kufitare. NJPIARK gjithashtu prodhon informacione të analizuar dhe raporte të situatës për të mbështetur MIK-un / planifikimin e sigurisë kufitare dhe vendimmarrjen në nivele strategjike, operacionale dhe taktike. Këto analiza përgatiten nga personeli i trajnuar dhe i vëzhguar që punon ngushtë së bashku dhe që zhvillon një analizë gjithëpërfshirëse të rrezikut kombëtar që mbulon të gjitha fushat e MIK dhe sigurinë kufitare. Për më tepër, Qendra ka një Dhomë Koordinuese Operacionale (DHKO) që shërben si pikë kontakti kombëtare për shkëmbimin e informacionit "në kohë reale" dhe ka qasje në të gjitha bazat përkatëse të të dhënave, si dhe mbulimin e plotë me CCTV të të gjitha PKK-ve.

Në Republikën e Kosovës masat parandaluese janë të orientuara veçanërisht në migracionin e paligjshëm / të parregullt, trafikimin e qenieve njerëzore (TQNj), të gjitha format e kontrabandimit të paligjshëm, duke përfshirë narkotikët, armët dhe eksplozivët, lëvizjet terroriste dhe kriminalitetin tjetër ndërkufitar.

Të gjitha autoritetet e përfshira në MIK veprojnë duke u bazuar në **procedurat** në fuqi që përfshijnë kryerjen e kontroleve të përbashkëta kufitare (kontrolle dhe vëzhgim) dhe mbajtjen e takimeve të rregullta ndërmjet agjencive në nivel lokal, rajonal dhe qendror, me qëllim shkëmbimin e informacionit, planifikimin, organizimin dhe kryerjen e përbashkët të operacioneve, kontroleve kufitare dhe ushtrimit të mbikëqyrjes.

Pavarësisht progresit të përgjithshëm të bërë në aspektin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive, autoritetet kufitare pranojnë se nevojitet ende një forcim i mëtejshëm, veçanërisht në lidhje me operacionet shumëpalëshe, hetimet, analizën e rrezikut dhe inteligjencën e përbashkët kriminale, në përpjekje për të luftuar në mënyrë më efektive krimin ndërkufitar dhe për të siguruar kufij më efektive dhe më efikas, të kontrolluar mirë dhe të sigurtë.

Përveç kësaj, ekzistojnë planet e reagimit emergjent në lidhje me sigurinë kufitare për të mbështetur veprimet e përbashkëta nga të gjitha autoritetet relevante dhe shërbimet emergjente në rast të: fatkeqësive natyrore; emergjencat e shëndetit publik (bio terrorizmi, sëmundje epidemike ose pandemike), ndonjë fluks të jashtëzakonshëm të emigrantëve / refugjatëve, aksidente të mëdha, duke përfshirë ndonjë zjarr / shpërthim me lëndime të rrezikshme për jetën dhe / ose humbje të jetës njerëzore ose dëmtim serioz të mjedisit (zjarreve), ndeshjeve të rënda në trafiku dhe kërcënimeve terroriste.

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve në lidhje me analizën e rrezikut është pjesë thelbësore e një sistemi kombëtar të analizës së riskut. Aktualisht, autoritetet kufitare të Republikës së Kosovës përpilojnë analizën e përbashkët të rrezikut dhe kërcënimeve përmes QKMK-së.

Ky raport analitik i përbashkët ndihmon në vendimmarrjen në të gjitha nivelet organizative dhe ndihmon në alokimin fleksibil, kosto-efikas dhe optimal të burimeve, duke përfshirë vendosjen e personelit dhe përdorimin efektiv të pajisjeve në zonat me rrezik më të lartë, duke mundësuar kështu ndarjen metodike të rrezikut.

Zhvillimi i ardhshëm i sistemit kombëtar të analizës së rrezikut për menaxhimin e kufijve do të bazohet në Modelin e Përbashkët të Analizës së Integruar të Riskut (CIRAM) të BE dhe qasjen ndaj analizës së rrezikut që përcakton rrezikun si funksion të kërcënimit, ndjeshmërisë dhe ndikimit, duke përfshirë masat plotësuese (aktivitetet në vendet e treta, bashkëpunimi me vendet fqinje (shumëpalëshe, dypalëshe dhe lokale), masat në kufijtë e jashtëm (kontrollat kufitare) dhe masat e tjera të kontrollit brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Me qëllim që autoritetet kufitare të trajtojnë në mënyrë efektive sfidat e shumta dhe kërcënimet në rritje që ballafaqohen me Republikën e Kosovës në lidhje me menaxhimin e kufijve dhe sigurinë, bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet agjencive është thelbësor në përcaktimin e vendosjes efektive të personelit. Për të arritur përdorimin më të mirë të **burimeve njerëzore**, Bordi Ekzekutiv i MIK-ut (duke përfshirë Drejtorët e secilit Autoriteti Kufitar), i mbështetur nga GKCD dhe me informacionin e dhënë nga QKMK, duhet të vendosë mbi ndarjen optimale të burimeve njerëzore (çfarë, pse, kush, kur dhe ku).

Të gjitha autoritetet kufitare kanë identifikuar nevojën për **trajnim** të mëtejshëm në fusha të specializuara që lidhen me MIK dhe në veçanti trajnimin e përbashkët ndërdisiplinor. Si pjesë e Strategjisë së re të MIK-ut do të kushtohet vëmendje krijimit të politikave afatgjata të trajnimit ndërmjet autoriteteve, duke siguruar trajnime të vazhdueshme lidhur me MIK, të përfshijë zhvillimin e një Kurrikule Themelore të Përbashkët ndërmjet autoriteteve (KTP) e përbërë nga module themelore dhe të specializuara të trajnimit të përafruara me Udhëzimet e BE-së për MIK, Doracakun / Kodin Praktik Schengen dhe KTP-në e Frontex-it. Përveç kësaj, ofrimi i trajnimit përkatës do të bëhet në bashkëpunim me BE-në dhe me partnerë të tjerë ndërkombëtarë. Trajnimi dhe edukimi i personelit të autoriteteve kufitare është nën shqyrtim dhe zhvillim të vazhdueshëm në mënyrë që të adresohen më mirë kërkesat e rrethanave të ndryshueshme dhe nevojave operacionale.

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit, midis autoriteteve kufitare është përmirësuar dukshëm, dhe si pjesë e procesit është krijuar një sistem i avancuar i menaxhimit të informacionit. Një element thelbësor në bashkëpunimin e suksesshëm midis autoriteteve është shfrytëzimi i përbashkët i bazave të të dhënave për shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve. QKMK-ja (NjPIARK) vepron si pikë kontakti shtetëtor për grumbullimin dhe shpërndarjen e informatave "në kohë reale" dhe ka qasje në të gjitha bazat përkatëse të të dhënave. Format e standardizuara të shkëmbimit të informatave janë inkorporuar në përputhje me praktikatat e zakonshme që përdoren në BE-në.

Avancimi dhe strukturimi i mëtejshëm i komunikimit ndërmjet autoriteteve kufitare në përputhje me standardet e BE-së dhe praktikat e mira në aspektin e TI-së, përfshirë zhvillimin e një Sistemi të Paralajmërimit të Hershëm⁶¹, i cili do të veprojë përmes QKMK-së, si një pikë e vetme e kontaktit. Përveç kësaj, procesi i avancimit dhe integritit të bazave të të dhënave përkatëse në mes të autoriteteve kufitare është në proces e sipër dhe është hartuar dhe miratuar një strategji e përbashkët për TI. Në lidhje me QKMK, lansimi i fundit i sistemit të ri për Menaxhimin e Informacionit Elektronik dhe Platformës së Inteligjencës së QKMK-së⁶², duke përfshirë instalimin e opsionit të softuerit të TI (QlikView), ka qenë një hap i madh përpara në zhvillimin e Qendrës.

Proceset e përdorura për shkëmbimin e të dhënave plotësisht respektojnë rregullat dhe legjislacionin⁶³ për mbrojtjen e të dhënave dhe të gjitha të dhënat janë të mbrojtura dhe të klasifikuara në mënyrë që të parandalohet qasja dhe përdorimi i paautorizuar.

Gjatë periudhës së Strategjisë së mëparshme të MIK, **infrastruktura** e PKK-ve, SPMK-ve, Terminaleve Doganorë dhe PIK-ve është përmirësuar dukshëm. Prosesi i përmirësimit dhe investimit në të gjithë infrastrukturën kufitare në të ardhmen, duke përfshirë edhe blerjen e **pajisjeve** të reja teknike, është një objektiv parësor i kësaj Strategjie, me qëllim që të mbështesë autoritetet kufitare në mënyrë efektive në kryerjen e detyrave të tyre të përcaktuara. Një pjesë e këtij procesi do të jetë zhvillimi i planeve të efikasitetit të kostos për krijimin e objekteve të përbashkëta dhe përdorimit të përbashkët dhe prokurimit të pajisjeve, të cilat në të njëjtën kohë do të rrisin bashkëpunimin ndërmjet agjencive.

Pajisja e të gjitha autoriteteve kufitare me burime të mjaftueshme teknike kërkon investime të konsiderueshme financiare dhe pasi që një nga përparësitë e MIK-ut është përdorimi i përbashkët i pajisjeve teknike, burimet e kufizuara financiare mund të lehtësohen nëpërmjet blerjes dhe përdorimit të formalizuar të pajisjeve. Gjithashtu, është e rëndësishme që blerja e pajisjeve teknike të koordinohet ndërmjet autoriteteve kufitare, sido që të jetë e përshtatshme, në mënyrë që të shmangen blerjet e dyfishta dhe të sigurohet kompatibiliteti (përshtatshmëria). Blerja e pajisjeve të reja teknike do të mbështetet nga buxheti i Kosovës dhe me ndihmën e BE-së dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë. Për më tepër, marrja e koordinuar dhe e përbashkët e pajisjeve teknike kërkon trajnim të përbashkët të përdoruesve, i cili do të bëhet nga ekspertët vendor në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

Infrastruktura dhe pajisjet përkatëse janë një komponent tepër i rëndësishëm i MIK-ut dhe shfrytëzimi i përbashkët i tyre luan një rol të madh në mbështetjen e përpjekjeve të autoriteteve kufitare, për të ofruar një shërbim profesional për qytetarët dhe përfituesit e tjerë.

⁶¹ Një sistem paralajmërues i plotë dhe efektiv i mbështet katër funksione kryesore: analiza e rrezikut, monitorimi dhe paralajmërimi; shpërndarjen dhe komunikimin; dhe një aftësi reagimi - https://en.wikipedia.org/wiki/Early_warning_system referohet

⁶² Financuar nga EXBS

⁶³ Ligji mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji Nr. 03 / L - 172)

9.3 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR NË KUADËR TË MIK-ut

Zhvillimi i Strategji së MIK-ut përbën një angazhim të veçantë në lidhje me sigurinë kufitare, në përputhje me **legjislacionin** në fuqi dhe luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e aktiviteteve për zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ndërtimin e besimit me vendet fqinje dhe më gjerë.

Zbatimi i Strategjisë së MIK-ut është një tregues i qartë për partnerët tanë ndërkombëtarë që Republika e Kosovës është e gatshme të kontribuojë në sigurinë rajonale dhe më gjerë dhe është një partner i besueshëm për vendet fqinje dhe të tjerët në fushën e kontrollit kufitar. Bashkëpunimi më i ngushtë ndërkombëtar në fushën e menaxhimit të kufijve me vendet fqinje dhe vendet e tjera relevante, është një mjet efektiv për të lehtësuar udhëtimin dhe tregtinë e ligjshme ndërkufitare dhe në të njëjtën kohë të luftojë krimin ndërkufitar dhe migrimin ilegal / të parregullt. Derisa niveli qendror fokusohet në koordinimin e aspekteve strategjike, siç është mbrojtja e përbashkët dhe mbikëqyrja e kufijve më në rrezik, bashkëpunimi në PKK fokusohet në çështjet operacionale ditore.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i Kosovës i referohet bashkëpunimit të ndarë në tri nivelet kryesore të:

- Bashkëpunimi lokal i autoriteteve kufitare në të dy anët e kufirit;
- Bashkëpunimi dypalësh ndërmjet vendeve që kufizohen (fqinje);
- Bashkëpunimi shumëpalësh për t'iu qasur më mirë fushave të përbashkëta që kanë të bëjnë me çështjet e menaxhimit të kufijve, rajonal dhe më gjerë jashtë vendit;

Bashkëpunimi ndërkombëtar midis autoriteteve që veprojnë në kufi, qoftë në nivel qendror apo lokal, është shumë i rëndësishëm dhe gjithashtu një mjet efektiv për rritjen e efikasitetit në lidhje me menaxhimin e kufirit. Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kufitare fqinje të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë Veriore gjykohet të jetë në një nivel shumë të mirë, të karakterizuar me takime të rregullta në nivel qendror, rajonal dhe lokal. Ky bashkëpunim synon të lehtësojë trajtimin efikas dhe efektiv të të gjitha çështjeve që lidhen me kufirin midis vendeve përkatëse.

Marrëdhëniet e mira me vendet fqinje, si në mënyrë dypalëshe ashtu edhe shumëpalëshe, janë një prioritet për Republikën e Kosovës. Bashkëpunimi ndërkombëtar është i domosdoshëm për zbatimin e suksesshëm të konceptit të MIK-ut, veçanërisht si një mjet për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin me të gjitha aspektet e menaxhimit të kufijve.

Aktualisht, në aspektin e MIK-ut, bashkëpunimi ndërkombëtar bazohet në **marrëveshjet bilaterale dhe protokollet** e nënshkruara me vendet fqinje. Përveç kësaj, Dogana e Kosovës është anëtare e Organizatës Botërore të Doganave (WCO) dhe Policia Kufitare e Kosovës nënshkroi një 'Marrëveshje Operacionale' me FRONTEX. Për më tepër, autoritetet kufitare të Kosovës marrin pjesë në një sërë konferencash / punëtori rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë kufitare dhe gjithashtu luajnë një rol aktiv në nismat e tjera të bashkëpunimit ndërkufitar. Bashkëpunimi ndërkombëtar i autoriteteve kufitare të Republikës së Kosovës do të përmirësohet më tej duke iu bashkangjitur konventave ndërkombëtare, duke marrë pjesë në

organizatat globale dhe rajonale dhe duke vendosur marrëveshje të mëtejshme bilaterale dhe multilaterale në të gjitha nivelet.

Në përputhje me marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale të nënshkruara me vendet fqinje (ndër-kufitare brenda autoritetit ose ndërmjet autoriteteve) **mekanizmat e duhur** për shkëmbimin e informacionit, analizën e përbashkët të rrezikut, patrullat e përbashkëta kufitare dhe operacionet janë funksionale. Përveç bashkëpunimit bilateral në disa raste janë krijuar pika kontakti shumëpalëshe me të gjitha vendet fqinje, duke përfshirë edhe Serbinë. Një faktor tjetër i rëndësishëm në aspektin e bashkëpunimit lokal dhe dypalësh (bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kufitare në të dy anët e kufirit) është operimi efektiv i PKK-ve. Ky aspekt i bashkëpunimit ndërkombëtar është negociuar me vendet fqinje dhe kur është e mundur, puna dhe **procedurat** ditore në PKK janë harmonizuar, duke përfshirë plane, operacione, hetime dhe takime të rregullta ndërkufitare në nivel qendror, rajonal dhe lokal.

Aty ku është e mundur, do të ndiqen marrëveshjet dypalëshe ndërkombëtare me qëllim të krijimit të kontrolleve sipas parimit "Një Ndalje-Një Kontroll" dhe PKK të Përbashkëta. Ndërkohë, autoritetet kufitare të Kosovës operojnë një sistem kontrolli ndërinstitucional "Një Ndalje-Një Kontroll" në të gjitha PKK-të dhe po punojnë drejt zhvillimit të konceptit "Një dritare të vetme"⁶⁴.

Një iniciativë posaçërisht pozitive në drejtim të krijimit të procedurave të përbashkëta ndërkufitare ishte hapja në janar 2019 e një Zyre Transitore në Portin e Durrësit (Shqipëri). Kjo zyrë shërben vetëm si pikë hyrjeje për mallrat në transit për Kosovë. Këto procedura të reja të harmonizuara të transitit ofrojnë stimuj biznesi për tregtarët kosovarë, të cilët tani i shmangin kostove të dyfishta doganore dhe kostove e agjentëve të mallrave. Përveç kësaj, një PSO e re është hartuar nga DK për aplikimin e procedurave të përbashkëta dhe analizën e rrezikut ndërmjet Doganës së Kosovës dhe asaj Shqiptare.

Organizimet dhe punëtoritë ndërkombëtare dhe rajonale të **trajnit** (përbrenda shërbimit dhe ndërmjet agjencive), studimi i programeve të tyre të këmbimit dhe shkëmbimi për të gjithë personelin e MIK-ut luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në dhënjen e mundësisë stafit nga të gjitha autoritetet kufitare për të parë (në mënyrë të drejtëpërdrejtë) dhe të mësojnë nga metodat e punës dhe praktikat operacionale të aplikuara nga agjencitë e tjera kufitare kombëtare dhe në të njëjtën kohë të nxisin kontaktet me homologët e vendeve të tjera. Autoritetet kufitare të Kosovës kanë përfituar nga shumë evenimente të tilla dhe i kanë zbatuar, aty ku ka qenë e mundur, mësimet e nxjerra në mjediset e tyre të punës, duke përmirësuar funksionalitetin e përgjithshëm të MIK-ut në Republikën e Kosovës.

Përsa i përket evenimenteve të ardhshme ndërkombëtare, trajnimeve dhe vizitave studimore, të gjitha autoritetet kufitare kanë identifikuar nevoja të mëtejshme për të fituar njohuri dhe përvoja të praktikave të mira të operuara nga autoritetet kufitare të vendeve të tjera, veçanërisht në fusha specifike që lidhen me MIK, përfshirë mbikëqyrjen e kufijve, shkëmbimin e mekanizmave të informacionit, analizën e rrezikut ndërmjet agjencive, hetimin penal dhe poashtu përdorimin operacional të pajisjeve teknike të specializuara, veçanërisht në lidhje me

⁶⁴ Bashkëpunimi Ndërkombëtar - Infrastruktura dhe Pajisjet – PKK-të e përbashkëta Vërmicë - Morinë me Shqipërinë i referohet

kontrollat dhe kontrollat e vijës së dytë. Mbështetja në organizimin e evenimenteve / punëtorive ndërkombëtare dhe rajonale të trajnimit, vizitave studimore dhe programeve të shkëmbimit në të ardhmen tashmë është premtuar nga partnerë të ndryshëm të BE-së dhe partnerë tjerë ndërkombëtarë.

Politikat ndërkombëtare të trajnimit, të cilat ofrojnë trajnime të vazhdueshme lidhur me MIK-un, aktualisht nuk janë gati, megjithatë ka plane për të përgatitur një Strategji të Përbashkët Ndërkombëtare për Trajnimin Ndër-Agjenci dhe Kurrikulën e Themelore të Përbashkët, në përputhje me Udhëzimet e BE-së për MIK, Doracakun / Kodin Praktik të Schengen-it dhe Skemën Doganore të BE-së. Përveç kësaj elementet e sistemeve të MIK-ut të operuara nga vendet fqinje do të jenë pjesë e kurrikulës për zyrtarët e rinj dhe inspektorët, me qëllim që të rrisin kuptimin e përgjithshëm të rëndësisë së MIK-ut në aspektin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar, p.sh. prapavija legislative, korniza institucionale dhe procedurat operacionale, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Trajnimi i gjuhëve është një tjetër veçori shumë e rëndësishme në arritjen e komunikimit efektiv ndërkufitar dhe bashkëpunimit, për të mos përmendur pjesëmarrjen në ngjarjet / punëtoritë ndërkombëtare të trajnimit, vizitat studimore dhe programet e shkëmbimit. Trajnimi në gjuhën angleze është veçanërisht i rëndësishëm kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në ngjarjet ndërkombëtare, por gjithashtu me vlerë të jashtëzakonshme është që të ketë personel me njohuri të mira në gjuhët e vendeve fqinje (mësime në gjuhën maqedonase dhe serbe), duke lejuar komunikim më të mirë në nivel lokal në PKK (bashkëpunimi ndërkufitar).

Të gjitha autoritetet kufitare aktualisht përfitojnë nga **komunikimi** dhe bashkëpunimi i mirë me vendet fqinje, veçanërisht me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Takimet e strukturuar, si përbrenda shërbimit dhe ndërmjet agjencive në nivel lokal dhe qendror, mbahen rregullisht dhe përfshijnë **shkëmbimin e informacionit**. Përveç kësaj, dy qendra të përbashkëta të bashkëpunimit policor (QBP) janë themeluar në PKK me Shqipërinë (Vërmicë - Morinë) dhe Maqedoninë e Veriut (Hani i Elezit - Bllace) dhe përveç kësaj është hapur një QBP Tripalëshe në Plavë në Mal të Zi⁶⁵ dhe ka zyrtarë të policisë kufitare nga Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi. Përveç KPK-ve, kapacitetet e QKMK-së janë duke u pëdorur, dhe në të ardhmen do të përdoren gjithnjë e më shumë, për qëllime të komunikimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar. Për më tepër DK operon sistemin e shkëmbimit sistematik të të dhënave elektronike (SEED), i cili përfshin shkëmbimin automatik të informacioneve të para-mbërritjes të koduara në 'kohë reale' ndërmjet Administratave Doganore Përfituese (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi)⁶⁶.

⁶⁵ Më 30 maj 2017 u hap Qendra e Bashkëpunimit Policor Tri-Palësh (QBP) në Plav. Themelimi i QBP-ve Tri-Palëshe 24/7 u mbështet nga EXBS, Ambasada Gjermane dhe IOM dhe u formua për të ndihmuar Policinë Kufitare në Mal të Zi, Shqipëri, Kosovë dhe në luftën kundër krimit ndërkufitar;

⁶⁶ SEED është dizajnuar për të ndërtuar kapacitetin e Administratave Doganore të Përfitimit duke zbatuar një zgjidhje sistematike për një koncept të përbashkët ose standarde rajonale në shkëmbimin e të dhënave doganore ndërmjet Përfituesit bazuar në informacionin e para-mbërritjes të koduar në "kohë reale". Në të njëjtën kohë, SEED vendos një standard për shkëmbimin e të dhënave të strukturuar me palët e

Fokusi kryesor i bashkëpunimit ndërkombëtar të Kosovës është aktualisht me vendet fqinje. Ky bashkëpunim për menaxhimin e kufijve bazohet në marrëveshjet dypalëshe ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i këtij bashkëpunimi për kontrollin kufitar është ruajtja dhe përmirësimi i mëtejshëm i menaxhimit të kufijve, rritja e luftës kundër krimit ndërkufitar dhe kontributi në lehtësimin e trafikut ndërkufitar. Bashkëpunimi i rregullt ndodh në nivele strategjike, operacionale dhe taktike dhe është fleksibël që të përshtatet me nevojat operacionale dhe situatat në kufi.

Si pjesë e modelit të kontrollit të qasjes në katër nivele në lidhje me bashkëpunimin me vendet e treta synon parandalimin e mëtejshëm të krimit ndërkufitar, duke përfshirë emigracionin e paligjshëm jashtë kufijve të Kosovës, si dhe lehtësimin e kthimit të shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme. Veprimet e ndërmarra në vendet e treta dhe bashkëpunimi me vendet e treta janë të rëndësishme për të përmirësuar efektivitetin e kontroleve kufitare. Republika e Kosovës synon të forcojë më tej bashkëpunimin me vendet e treta, duke vendosur metoda dhe procedura të harmonizuara dhe të definuara të punës në mënyrë që të lehtësojë zbatimin efektiv dhe efikas të konceptit të MIK-ut të BE-së. Bashkëpunimi i rregullt me vendet e treta do të rritet dhe do të bazohet në marrëveshje ndërkombëtare, protokolle, memorandume të mirëkuptimit dhe praktika të tjera të vendosura. Me rëndësi të madhe në aspektin e komunikimit ndërkombëtar ishin nënshkrimi i 'Marrëveshjes së Punës' me FRONTEX⁶⁷. Që nga nënshkrimi i marrëveshjes PK tani i kontribuon të dhënave në Rrjetin e Analizave të Ballkanit Perëndimor (WBAN) dhe gjithashtu merr pjesë në operacionet / aktivitetet / rrjetëzimin e FRONTEX, i cili ka kontribuar në përmirësimin e rezultateve të zbatimit. Kosova synon të ndërtojë këtë zhvillim shumë pozitiv duke u bërë anëtar i plotë i organizatave ndërkombëtare të bashkëpunimit si INTER-POL⁶⁸, EUROPOL⁶⁹ dhe FRONTEX etj. Me qëllim që të ketë komunikim më efikas dhe efektiv dhe shkëmbim informacioni në nivel ndërkombëtar, duke përmirësuar kapacitetet e autoriteteve kufitare për të luftuar të gjitha format e kriminalitetit ndërkufitar dhe për të luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e kufijve të vendit dhe gjithashtu të rajonit, si dhe të BE-së. Niveli dhe cilësia e shkëmbimit të informacionit me vendet fqinje, rajonin dhe më gjerë do të përmirësohet me zhvillimin dhe instalimin e mjeteve të reja dhe moderne të IT-së dhe mjeteve të komunikimit në përputhje me praktikën më të mira të operuara në BE dhe në vendet e tjera.

tjera të interesuara (p.sh. agjencitë dhe institucionet e tjera shtetërore, pjesëmarrësit në procedurat doganore, si dhe ndërmjet departamenteve ose ndarjeve individuale) dhe iniciativave.

⁶⁷ https://en.wikipedia.org/wiki/European_Border_and_Coast_Guard_Agency

⁶⁸ <https://en.wikipedia.org/wiki/Interpol>

⁶⁹ <https://en.wikipedia.org/wiki/Europol>

Një mjet i tillë do të jetë futja e Informacionit Paraprak mbi Pasagjerët (API) në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës në përputhje me të gjitha aeroportet e BE-së. Marrja e informacionit paraprak do t'i lejojë autoritetet kufitare të procesojnë pasagjerët në mënyrë më efikase dhe do të çojë deri tek përmirësi i shënjestrimit (targeting) dhe rezultateve më të mira të zbatimit të ligjit. Futja e API-së do t'u mundësojë autoriteteve kufitare të kompletojnë analizën e rrezikut dhe t'i përqendrojnë përpjekjet e tyre ndaj atyre udhëtarëve që konsiderohen të rrezikshëm, duke reduktuar kohën e shpenzuar për ata që konsiderohen me rrezik të ulët. API duhet të merret nga transportuesit e fluturimit, sa më shpejt të jetë e mundur dhe do të mund të përdoret nga PK dhe DK. Përveç kësaj, Kosova do të kërkojë gjithashtu zbatimin e qasjes në të dhënat e emrave të pasagjerëve (PNR ó Passenger Name Record). PNR-të tani shpërndahen në mënyrë rutinore ndërmjet agjencive qeveritare në të gjithë botën, siç janë policia kufitare, doganat dhe agjencitë për zbatim të ligjit⁷⁰. PNR është një mjet shumë i rëndësishëm i zbatimit të ligjit që lejon autoritetet kufitare të parandalojnë, zbulojnë dhe hetojnë të gjitha format e krimit të rëndë (terrorizëm, trafikim droge, trafikim njerëzor, eksploatimi seksual të fëmijëve dhe të tjera). Me kalimin e kohës API dhe PNR do të jenë të ndërlidhura me sistemin e SMK-së të PK-së dhe do të operohet plotësisht në aeroport.

Përpjekje të mëtejshme do të bëhen në avancimin e komunikimit ndërkufitar midis autoriteteve kufitare nëpërmjet futjes së mjeteve të reja të IT-së, duke përfshirë zhvillimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm me të gjitha vendet fqinje për të siguruar shkëmbim të shpejtë, efikas dhe efektiv të informacionit. Këto sisteme të paralajmërimit të hershëm do të veprojnë si masa sigurie në rastet e fatkeqësive natyrore, emergjencat e shëndetit publik, aksidente të mëdha, duke përfshirë ndonjë zjarr ose shpërthim me kërcënim për jetën njerëzore ose ndonjë rrezik serioz i dëmtimit të mjedisit (zjarreve në pyje dhe shkurre), ndeshje të rënda në trafik, dhe kërcënimet terroriste etj.

Për më tepër, do të ndiqet përputhshmëria e sistemeve të TI-së që lidhen me kufijtë që operohen nga autoritetet kufitare fqinje. Aktualisht PK dhe homologët e tyre të policisë kufitare shqiptare operojnë bashkërisht me sistemet e tyre të menaxhimit të kufirit (integrimi i sistemeve BMS dhe TIMS⁷¹). Një synim tjetër është rritja e nivelit të komunikimit të drejtpërdrejtë me autoritetet kufitare të vendeve fqinje, krijimi i pikave të kontaktit brenda

⁷⁰ Shteteve anëtare të BE-së (MS – Member States) u është kërkuar të zbatojnë qasjen në të dhënat e PNR-së në vitin 2018 me krijimin e entiteteve specifike përgjegjëse për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave të PNR (Njësitë e Informacionit të Pasagjerëve (PIU – Passenger Information Unit)). MS gjithashtu janë të detyruar të miratojnë lista e autoriteteve kompetente që kanë të drejtë të kërkojnë ose të marrin të dhëna PNR - https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/police-cooperation/information-exchange/pnr_en

⁷¹ Total Information Management System (TIMS)

shërbimit dhe ato ndërinstitucionale, duke përfshirë hollësitë e telefonit dhe të postës elektronike dhe, kur është e përshtatshme, radio komunikimit.

Një fushatë e re për informimin dhe sensibilizimin e publikut duhet të fillon në vitin 2019 duke promovuar numra falas të telefonit për publikun për të raportuar të gjitha format e kriminalitetit ndërkufitar, duke përfshirë rastet e korrupsionit të supozuar. Fushata do të përfshijë mbulimin e plotë nga mediat dhe botimin e njoftimeve të reja publike, etj, që lidhen me çështjet e kufirit. Përveç kësaj, një strategji për informimin publik ndërkufitar do të zhvillohet për të përfshirë rritjen e informacionit në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (QKMK), në përputhje me òpraktikat e mira të BE-së dhe të tjera ndërkombëtare.

Infrastruktura në të gjitha PKK-të është përmirësuar dukshëm gjatë viteve të fundit, me theks të veçantë në vendosjen e PKK-ve të përbashkëta ose të bashkangjitura. Procesi i përmirësimit dhe investimit në të gjithë infrastrukturën kufitare, duke përfshirë sigurimin e pajisjeve teknike, është me rëndësi parësore për të mbështetur autoritetet kufitare në mënyrë efektive për të kryer detyrat e tyre të caktuara.

Në fund të vitit 2018 u hap një PKK i ri i përbashkët me Shqipërinë në Vërmicë ó Morinë, dhe një tjetër PKK e përbashkët me Maqedoninë Veriore në Stançiq - Bellanovc është në ndërtim e sipër⁷². Përveç kësaj, si pjesë e dialogut të lehtësuar nga BE-ja në mes të Kosovës dhe Serbisë, konkretisht Protokoli Teknik i MIK-ut (PT-MIK) i miratuar, ndërtimi i gjashtë pikëkalimeve të përbashkëta (PKP) me Serbinë në Bërnjak, Dhe të Bardhë, Jarinje, Merdarë, Muçibabë dhe Mutivodë janë paraparë. Aktualisht, dy nga PKP-të e përhershme janë afër përfundimit në Merdarë dhe Mutivodë. Përveç kësaj, PKK-ja hekurudhore ndërkufitare në Jarinje-Leshak ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, aktualisht vetëm një stacion treni pa objekte të përshtatshme òpunuese, duhet të përafrohet dialogut PT-MIK të lehtësuar nga BE, në mënyrë që të themelohet një stacion hekurudhor i përbashkët në një vend të rënë dakord reciprocisht afër PKP Jarinje, ku të dy grupet e autoriteteve kufitare mund të kryejnë kontrole me një ndalesë.

Qëllimi i ardhshëm është ndërtimi i më shumë PKK-ve të përbashkëta me vendet fqinje, në veçanti me Mal të Zi. Një pjesë e këtij procesi është zhvillimi i planeve me kosto efektive me shtetet fqinje për krijimin e objekteve të përbashkëta dhe përdorimin e përbashkët dhe sigurimin e pajisjeve, të cilat në të njëjtën kohë edhe do të rrisin bashkëpunimin ndërkufitar. Për më tepër, të gjitha autoritetet përgjegjëse për MIK, do të bashkëpunojnë ngushtë me vendet fqinje dhe partnerët ndërkombëtarë, në veçanti me BE-në, në planet për të ndërtuar struktura të tjera të përbashkëta ndërkufitare. Përveç kësaj, sigurimi i pajisjeve moderne për përdorim nga

⁷² Dy PKK të përbashkëta me Shqipërinë (Vërmicë - Morinë) dhe me Maqedoninë e Veriut në (Stançiq-Bellanovc) financuar nga BE

autoritetet kufitare të të dy vendeve (ndërkufitare) do të bëhet me qëllim që të ndihmojë në parandalimin dhe në zbulimin efektiv të të gjitha formave të kriminalitetit ndërkufitar. Një synim tjetër është vendosja e marrëveshjeve dypalëshe të bashkëpunimit midis vendeve fqinje, duke lejuar përdorimin e përbashkët të aseteve infrastrukturale dhe pajisjeve. Të gjitha këto zhvillime i shërbejnë objektivit kryesor të MIK-ut në arritjen e kufijve të hapur, por të kontrolluar mirë dhe sigurt.

Sa i përket zhvillimit të mëtutjeshëm të objekteve të përdorura nga AUV, do të fillojë planifikimi për ndërtimin e vendeve të Përbashkëta të Inspektimit Kufitar (PIK) me vendet fqinje për inspektimin e bimëve, të produkteve bimore, ushqimore dhe të blegtorisë. PIK-ët duhet të vendosen larg lëvizjes së të gjitha mënyrave të trafikut, në mënyrë që të sigurojnë pjesë adekuate për inspektim në përputhje me standardet e BE dhe për të shmangur kohët e pritjes të panevojshme për ndërmarrjen dhe procesimin e kafshëve të gjalla. Këto PIK duhet gjithashtu të kenë objekte karantine për kafshët e gjalla, të cilat mund të përdoren për ekzaminimin veterinar dhe testimin e kafshëve të dyshuara për kontrabandë, pasi kafshët e gjalla paraqesin një rrezik të lartë sepse ato mund të jenë bartëse të sëmundjeve për bagëtinë dhe njerëzit. Ndërtimi dhe pajisja e PIK-ve të përbashkët do të përfitojnë nga mbështetja e ofruar nga fondet e BE-së dhe asistencë nga partnerë të tjerë ndërkombëtarë.

10 Bashkëpunimi në fushën e migrimit dhe vizave

Strategjia Zhvillimore e Kosovës 2016-2021 i referohet kapitullit të zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe mundësitë për fitimin e aftësive përmes migrimit, apo kthimit të trurit nga diaspora. Strategjia Shtetërore për Migrim 2020-2025 është Strategjia e tretë që mbulon këtë fushë dhe e përcjell strategjinë e dytë të Migrimit 2013-2018. Kjo strategji synon zbatimin e objektivave të institucioneve të ndryshme vendore në fushën e migrimit të rregullt, atij të parregullt, azilit, migrimit dhe zhvillimit, si dhe menaxhimit dhe qeverisjes së migrimit.

Kosova ka zhvilluar një kornizë të mirëfilltë ligjore dhe strategjike në menaxhimin e migrimit duke përfshirë edhe mekanizmat insitucional që janë të mandatuar të koordinojnë dhe zbatojnë politikën e migrimit. Për më tepër përafrimi i legjislacionit në fushën e migrimit me Acquis të BE-së vazhdon në përputhje me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit me Bashkimin Evropian.

Kjo e MIK-ut është në harmoni të plotë me Strategjinë Shtetërore për Migrim dhe Planin i Veprimit 2013-2018 e cila është dokumenti kryesor shtetëror i politikave në fushën e migrimit. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj strategjie është avancimi i një sistemi transparent dhe efektiv për menaxhimin e migrimit të rregullt, si dhe parandalimin të gjitha formave të migrimit të parregullt. Strategjia dhe plani i veprimit parasheh masa specifike për krijimin e kapaciteteve dhe strukturave administrative përgjegjëse për parandalimin e migrimit të parregullt,

promovimin e migrimit të rregullt dhe qarkor dhe transformimin e migrimit në faktorë të zhvillimit ekonomik të vendit.

Policia Kufitare në bashkëpunim me autoritet të tjera të përfshira në MIK dhe UNHCR, IOM dhe organizatat tjera duhet të luftojnë dhe parandalojnë migrimin e parregullt të njerëzve, ndërsa atyre personave që kërkojnë azil t'ju ofroj gjithë ndihmën duke u bazuar në konventat ndërkombëtare për refugjat.

Republika e Kosovës ka aplikuar sistemin e vizave ndaj një numërit të mardh të shteteve, kjo është bere me qëllim të parandalimit të ndonjë fluksi të madh të migrimit të parregullt si dhe për çështje të sigurisë shtetërore.

Dhënja e vizave për qytetaret e këtyre vendeve kalon nëpërmes një procesi të gjatë të verifikimit të tyre, andaj në të ardhmë Policia Kufitare duhet të zvogëlojë në minimum dhënien e vizave në kufi për këta shtetas. Kjo përjashton dhënien e vizave në raste të veçanta e sidomos dhënien e vizave për çështje humanitare të cilët për arsye të natyrës së urgjencës nuk ka kohë dhe mundësi të kalon të procedurën e rregullt për marrjen e vizave.

Problemi i migrimit të parregullt dhe të rregullt duhet të trajtohet në harmoni të plote me ligjet në fuqi dhe konventat ndërkombëtare si dhe me Strategjinë Shtetërore Për Migrim, si strategji primare të trajtimit të këtij problemi.

Mekanizmi Institucional

Koordinatorit Kombëtar për MIK, përveç tjerash është përgjegjës për:

- Identifikimin e përparësive në fushën e MIK-ut;
- Sigurimin e mjeteve të mjaftueshme financiare ó nga Buxheti i Kosovës, nga fondet dhe donoret e jashtëm, për zbatimin e reformave në kuadër të MIK-ut;
- Miratimin e dokumenteve zyrtare në lidhje me MIK-un;
- Monitorimin e zbatimit të Strategjisë së MIK-ut dhe Planit të Veprimit;
- Bashkërendimin e veprimeve të Strategjisë për MIK me vendet fqinje, si dhe monitorimin e vënies në zbatim të aktiviteteve që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e bashkërendimit dhe bashkëpunimit të MIK-ut me organet e tjera bashkërenduese të nivelit të lartë në rajon.

Bordi Ekzekutiv i MIK-ut funksionon me qëllim të bashkërendimit dhe bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK. Bordi Ekzekutiv për MIK përbëhet nga Koordinatori Kombëtar për MIK, Drejtori i Departamentit të Policisë Kufitare, Drejtori i Përgjithshëm i DK-së dhe Kryeshefi Ekzekutiv i AUV-it, si dhe përgjegjësitë e MIK-ut nga autoritetet. Në mbledhjet e Bordit Ekzekutiv për MIK, me ftesë të Koordinatorit Kombëtar

për MIK, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të organizatave ose përfaqësues të shteteve fqinje dhe shteteve tjera.

Sekretariati i MIK-ut

- E drejtë dhe detyrë themelore e Sekretariatit është mbledhja e informacioneve dhe të dhënave nga institucionet tjera për zbatimin e Strategjive Nacionale nën përgjegjësinë e MPB-së;
- Sekretariati bën analizimin dhe vlerësimin e atyre informatave;
- Sekretariati bën përgatitjen e raporteve analitike për Koordinatorin Nacional. Sekretariati nën mbikëqyrjen e Koordinatorit Nacional bën monitorimin dhe vlerësimin e kryerjes së aktiviteteve që dalin nga plani i veprimit;
- Propozon ndryshime dhe përmirësime në sistemet dhe mekanizmat e Strategjisë Nacionale përmes Koordinatorit Nacional;
- Sekretariati rekomandon dhe këshillon Koordinatorin Nacional për hapat që duhet të ndërmerren në drejtim të zbatimit të Strategjisë për MIK;
- Në emër të Zyrës së Koordinatorit, Sekretariati prezanton zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë Nacionale për MIK;
- Nxiti rritjen e transparencës së veprimtarisë së institucioneve shtetërore, të përfshira në Strategjitë Nacionale duke bashkëpunuar me institucione tjera dhe shoqërinë civile;
- Sekretariati administron bazën e të dhënave të MIK-ut dhe i raporton Koordinatorit Nacional;
- Monitoron veprimtarinë e institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Strategjisë për MIK-un.

Zbatimi, Monitorimi dhe Vlerësimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit

Në mënyrë të përcaktohet realizimi i planit të veprimit dhe që ai të përshtatet ndryshimeve dhe rrethanave, prioritetëve, situatave të gjitha elementet do të jenë subjekt i zbatimit, monitorimit, vlerësimit dhe rishikimit në periudha të rregullta kohore.

Koordinatori Nacional për MIK formon grupin monitorues për vlerësimin e zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë (PVS-së) për MIK-ut. Grupi monitorues përpilon raporte monitoruese të rregullta dhe ad-hoc, ku do të përmbledhet përparimi që është bërë në zbatimin e planit të veprimit, zbatimin e aktiviteteve, arritjen e rezultateve, shpenzimet e bëra, burimet e shfrytëzuara dhe rreziqet e mundshme të Strategjisë së MIK-ut. Kjo do të arrihet nëpërmjet një procesi të mbledhjes së vazhdueshme, sistematike dhe analizave të mirëfillta të informacioneve dhe të dhënave (takime, raporte të aktiviteteve, etj.), nga agjencitë e përfshira në MIK. Kjo

ndihmon për të vlerësuar nëse qëllimet e vendosura janë arritur ose janë afër që të arrihen dhe kjo gjithashtu ndihmon më pastaj për një vendimmarrje sa më efektive.

Vlerësimi përfshinë një vlerësim të efikasitetit, efektivitetit, ndikimit, lidhjen dhe qëndrueshmërinë e planit të veprimit dhe strategjisë. Kur do që të bëhet vlerësimi, informacioni i njëjtë është relevant që është përdorur për monitorim, por me një fokus të ndryshëm dhe të plotësohet me informata shtesë. Qëllimi i vlerësimit është që të merret një pamje më globale e përparimit të bërë në zbatim. Kjo bëhet duke krahasuar rezultatet me objektivat e planit të veprimit dhe strategjisë, duke mos qenë të përqendruar vetëm të numri i objektivave që janë përmbushur, por edhe në cilësinë e rezultateve të arritura. Vlerësimet duhet të kryhen në intervale periodike, p.sh.: në mes të përmbushjes së aktiviteteve dhe pas përmbushjes së tyre. Rekomandohet që në këtë proces të përfshihen ekspertë të jashtëm, të cilët janë të pavarur. Rezultatet e vlerësimit duhet të përdoren për të përfshirë mësimet e nxjerra në procesin e zbatimit, për të paraqitur ndryshimet e mundshme dhe për të marrë parasysh mundësinë e ndryshimit të procedurave (politikës). Raportet e vlerësimit mund të shërbejnë si bazë për procesin e ardhshëm vendimmarrës. Plani i Veprimit reflekton përputhshmërinë e tij me kornizën e përgjithshme të Strategjisë Shtetërore për MIK. Plani i Veprimit do të rishikohet në fund të çdo viti në mënyrë që të sigurohet zbatimi i Strategjisë dhe harmonizimi me trendët vendore dhe ndërkombëtarë.

RISHIKIMI

Të dyja rezultatet e vlerësimit dhe monitorimit të dhënave janë të nevojshme për rishikimin e planit të veprimit dhe strategjisë. Dokumenti i strategjisë nuk duhet të rishikohet shumë shpesh në krahasim me planin e veprimit, përderisa strategjitë kombëtare janë krijuar zakonisht për të mbuluar një afat më të gjatë deri në pesë vjet. Megjithatë, në qoftë se situata në vend apo politika kombëtare lidhur me menaxhimin e kufijve ndryshon në mënyrë drastike, disa objektiva në strategji dhe si rrjedhojë plani i veprimit duhet të rishikohen. Strategjia duhet të rishikohet periodikisht, për shembull, çdo tre deri në katër vjet, dhe plotësohet dhe ndryshohet (amendamentohet) në përputhje me rrethanat ku duhet të reflektoj prioritetet dhe zhvillimet kombëtare. Plani i veprimit duhet të rishikohet mundësisht çdo vit, por më së largu çdo dy vite. Nëse vlerësimi pasqyron se disa aktivitete nuk kanë çuar në rezultatet e pritshme, do të jetë e nevojshme që të rishikohen gjithashtu edhe veprimet apo objektivat. Hapi i parë për trupin

zbatues është të identifikojnë (rendisin) plotësimet e nevojshme ose fshirjet e pjesëve nga strategjia dhe plani i veprimit.

ANEKS 1

PARIMET E PËRMBUSHJES SË OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË

Në përmbushjen e objektivave të parapara në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për MIK, institucionet dhe agjencitë e Republikës së Kosovës udhëhiqen nga parimet vijuese:

- **Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë** ó Veprimet e ndërmarra për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ato ndërkufitare dhe më gjerë duhet të bazohen në dispozitat e parapara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin në fuqi, marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe standardet e BE-së.
- **Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut**- Ky parim nënkupton garantimin e lirive dhe të drejtave të të gjithë individëve, përfshirë këtu edhe parimin e mos kthimit të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, gjatë të gjitha fazave të angazhimit të institucioneve në zbatimin e ligjit.
- **Parimi i sigurisë** - Ky parim nënkupton garantimin e të drejtës për siguri dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët nëpërmjet parandalimit dhe zvogëlimit të gjitha formave të krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ato ndërkufitare dhe më gjerë.
- **Parimi i prioritetit** ó Parandalimi dhe luftimi i krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ato ndërkufitare dhe më gjerë është prioritet për institucionet dhe agjencitë e Republikës së Kosovës. Përkushtimi i përgjithshëm për t'u marrë seriozisht me këto probleme është element qenësor.
- **Parimi i profesionalizmit** ó Parandalimi dhe luftimi i krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ato ndërkufitare dhe më gjerë, kërkon ekspertë të mirë, shkëmbim të përvojave, mjete të përshtatshme / praktika më të mira. Kjo nënkupton kombinim të trajnimit, edukimit dhe zhvillimit profesional për institucionet dhe agjencitë e Republikës së Kosovës, si dhe përkujdesjen për të rekrutuar vetëm specialistët e cilësisë më të mirë.
- **Parimi i vazhdimësisë** ó Të gjitha aktivitetet e parapara duhet të shihen si pjesë e një strategjie të vazhdueshme. Kjo është sidomos e rëndësishme për arsye se do të

ekzistojnë përkufizimet kohore administrative/procedurale, si dhe për arsye se iniciativat /aktivitetet e ndryshme, është e nevojshme të ndërlidhen në veprime të cilat do të zgjasin me vite të tëra.

- **Parimi i besueshmërisë** - Institucionet dhe agjencitë përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e krimit dhe akteve të kundërligjshme duhet të kujdesen për ndërtimin e besimit në ruajtjen e integritetit të hetimeve, të dhënave dhe informacioneve nga keqpërdorimi nga ata që kanë qasje në to.
- **Parimi i proporcionalitetit** - Nënkupton ushtrimin e autoritetit të institucioneve dhe autoriteteve që merren në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe akteve të kundërligjshme, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në nivelin që nevojitet për të arritur objektivat legjitime, me mjete dhe metoda të përshtatshme dhe në kohë sa më të shkurtër të mundshme.
- **Parimi i analizës dhe qasjes shkencore dhe pro aktive** - Kryerja e analizave të paanshëm të fakteve dhe përditësimi i masave lidhur me zbatimin e politikës kombëtare të Kosovës në baza të rregullta.
- **Parimi i llogaridhënies, monitorimit dhe kontrollit** - Zhvillimi iraporteve të rregullta mbisituatën e përgjithshme të MIK-ut në Kosovë.

Aneksi 2.

Korniza Ligjore

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
2. Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, si dhe me Ligjin nr. 06/L-013 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i Ndryshuar dhe Plotësuar me ligjin nr. 04/L-214;
3. Ligji 04 / L-216 për Bashkëpunimin ndërmjet Autoriteteve të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit;
4. Ligji nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura;
5. Ligji nr. 03/L-038 për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës;
6. Ligji nr. 03/L-054 për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës;
7. Ligji nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-089 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë;
8. Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit;
9. Ligji nr. 2004/34 Kundër Korrupsionit;
10. Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës;
11. Kodi NR. 04/L-123 i Procedurës Penale;

12. Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;
13. Ligji nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale;
14. Ligji nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;
15. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë;
16. Ligji nr. 03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-217 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit;
17. Ligji nr. 02/L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin;
18. Ligji nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave;
19. Ligji nr. 03/L-99 për Letërnyoftimin, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-126 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-099 për letërnyoftimin;
20. Ligji nr. 02/L-118 për Emrin Personal;
21. Ligji nr. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor;
22. Ligji nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi
23. Ligji nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor;
24. Ligjin nr. 04/L-069 për të Huajt, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt;
25. Ligji nr. 06/L-026 për Azil;
26. Ligji nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës;
27. Ligji nr. 05/L-022 për Armë;
28. Ligji nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike;
29. Ligji nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje përkatëse të sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri;
30. Ligji nr. 04/L-022 për Përdorim Civil të Eksplozivëve;
31. Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
32. Ligji nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë;
33. Ligji nr. 03/L-109 Kodi Doganor dhe i Akcizave, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-099 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, me Ligjin nr. 04/L-115 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës, si dhe me Ligjin nr. 04/L-273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës;
34. Ligji nr. 04/L-048 për Tregti me Jashtë;
35. Ligji nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe;
36. Ligji nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale;
37. Ligji nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja;
38. Ligji nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar;
39. Ligji nr. 2004/21 për Veterinarinë;
40. Ligji nr. 02/L-109 për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse;
41. Ligji nr. 02/L-10 për Përkujdesjen ndaj Kafshëve;
42. Ligji për 04/L -190 Produkte dhe Pajisje Medicinale; Ligji për Produktet Medicinale Veterinare;
43. Ligji nr. 04/L-078 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-189 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-078 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve;
44. Ligji nr. 04/L -190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
45. Ligji nr. 03/L-016 për Ushqimin;

46. Ligji nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve;
47. Ligji nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve;
48. Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;
49. Ligji nr. 03/L-119 për Produktet Biocide dhe shtojcat e ligjit;
50. Ligji nr. 02/L-98 për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve;
51. Ligji nr. 02/L-128 për Barnat Narkotike dhe Substancat Psikotrope dhe Prekursor;
52. Ligji nr. 02/L-30 për Mbeturina dhe Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina - shtojca
53. Ligji nr. 04/L-197 për Kimikate;
54. Ligji nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misionëve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj;
55. Ligji nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar;
56. Ligji nr. 06/L-029 për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore;
57. Ligji nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera;
58. Ligji nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme;
59. Ligji nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion;
60. Ligji nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor.